



Një vit i rritjes së qëndrueshme



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Raporti Vjetor i TEB Sh.A. për vitin 2014

PËRMBAJTJA

PËR TEB SH.A.

- 2 PROFILI I KORPORATËS
- 4 VIZIONI, MISIONI DHE STRATEGJIA JONË
- 6 VLERAT TONA THEMELORE:
- 7 STRUKTURA E AKSIONARËVE

PËRMBLEDHJA E VITIT 2014 DHE PERSPEKTIVA PËR VITIN 2015

- 10 PASQYRA MAKROEKONOMIKE
- 12 LETËR NGA KRYESUESI
- 13 LETËR NGA KRYESUESI I BORDIT

TEB SH.A. NË VITIN 2014

- 16 VËSHTRIM I SHPEJTË PËR VITIN 2014
- 18 TEB-I NË SHIFRA
- 20 INDIKATORËT KYÇË FINANCIARË

AKTIVITETET DHE PROJEKSIONET

- 22 SHËRBIMET BANKARE PËR INDIVIDË
- 24 BIZNESI I KARTELAVE
- 26 SHËRBIMET BANKARE PËR NVM-TË
- 28 SHËRBIMET BANKARE KOMERCIALE DHE PËR KORPORATA
- 30 FINANCAT TREGTARE
- 31 MENAXHIMI I PARASË DHE SISTEMET E PAGESAVE
- 33 THESARI
- 34 BURIMET NJERËZORE
- 36 ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I PROCESEVE
- 37 TEKNOLOGJIA INFORMATIVE
- 38 SIGURIA E INFORMACIONIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

MENAXHMENTI/QEVERISJA KORPORATIVE

- 40 BORDI I DREJTORËVE
- 42 KOMITETET
- 45 AUDITIMI I BRENDSHËM
- 46 MENAXHIMI I RREZIKUT
- 48 PAJTUESHMËRIA, KONTROLLI I BRENDSHËM DHE RREZIKU OPERACIONAL

RAPORTËT FINANCIARE

- 50 PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA MË PËRËFTJË ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) PËR VITIN QË PËRFUNDOI MË 31 DHJËTOR, 2014



TË JESH NJË BANKË E PËRGJEGJSHME FOKUSIMI NË TË ARDHMEN: NE DO TË PËRPIQEMI TË RRISIM MË TEJ KËNAQËSINË E KLIENTËVE TANË.

E SHTYRË NGA NJË SHËRBIM SOLID I OFRUAR PERSONAVE PRIVATË SI DHE BIZNESEVE, TEB SH.A. GJITHMONË E KA KONSIDERUAR ETIKËN SI THEMELORE PËR MISIONIN E SAJ. MARRËDHËNIA E BESIMIT ME KLIENTËT E SAJ QË BANKA KA NDËRTUAR ME KALIMIN E KOHËS SOT PËRBËN ASETIN E SAJ NUMËR NJË.

VLERAT TONA

- TË NDERSHËM DHE TË BESUESHËM
- DREJTUES, PIONIERË DHE INOVATIVË
- TË ORIENTUAR KAH KLIENTI ME FOKUS TË FUQISHËM NË CILËSI TË LARTË
- ME RESPEKT PËR SHOQËRINË, TË DREJTAT NJERËZORE DHE MJEDISIN
- TRANSPARENTË

PROFILI I KORPORATËS

Të jesh një Bankë e përgjegjshme

Fokusimi në të ardhmen: ne do të përpiqemi të rrisim më tej kënaqësinë e klientëve tanë.

Pas gjashtë viteve të suksesshme në Kosovë, TEB Sh.A. ose TEB-i siç na thërrasin shumë nga klientët tanë, është bërë një nga emrat më të shquar në sektorin bankar, duke fituar një reputacion të merituar për shërbimin e shkëlqyer. Në mënyrë sistematike, ne kemi udhëhequr duke përmbushur nevojat për shërbime bankare dhe nevojat financiare të individëve dhe bizneseve duke filluar një numër 'gjërash të para' për tregun e Kosovës përgjatë historisë sonë shtatë vjeçare.

Në një botë që ndryshon shpejtë, TEB-i është atje për të mbështetur klientët dhe punonjësit në mënyrë të vazhdueshme. Kjo mundësi gjithashtu bazohet në pozitën tonë si anëtar i mirënjohur i Grupit TEB. Grupi është formuar përmes një sipërmarrje të përbashkët në mes një prej institucioneve financiare më të fuqishme në bote, BNP Paribas dhe një prej bankave më me reputacion në Turqi, Turk Ekonomi Bankasi.

Ne synojmë të jemi një bankë e përgjegjshme. Për këtë arsye ne ndjekim një sërë aktivitetesh të përgjegjshme sociale që i kontribuojnë zhvillimit social. Për TEB-in, përgjegjësia sociale e korporatës është një mjet shumë i vlefshëm dhe thelbësor që plotëson misionin tonë ekonomik. Prandaj, përveç ofrimit të një shërbimi të shkëlqyer, inovativ dhe të përgjegjshëm për klientët tanë, ne ndërmarrim projekte që janë të dizajnuara për të bërë diferencë në arsim, kulturë dhe sport. Ne kemi synuar ndikime pozitive për numrin më të madh të personave në Kosovë.

Çka bëjmë ne

Për TEB-in, klienti është qendra e çdo gjëje që bëjmë. Klientët tanë janë të veçantë dhe të vlerësuar. Kjo shprehet në të gjitha produktet dhe shërbimet e dizajnuara në mënyrë speciale që ne ofrojmë për grupe të ndryshme të klientëve, nga ndërmarrësit te pensionistët dhe nga punonjësit te studentët.

Rritja sistematike, vit pas viti në rritjen tonë të shërbimit, numrin e klientëve, vëllimin e transaksioneve dhe burime njerëzore është konfirmim se ne:

- vazhdimisht zgjerojmë gamën e produkteve dhe shërbimeve bankare jo të degës. Ne ofrojmë të gjitha llojet e produkteve dhe shërbimeve bankare të fokusuar në cilësi që njerëzve iu duhen në faza të ndryshme gjatë jetës së tyre - e gjitha përmes rritjes tonë të zgjeruar dhe me shumë kanale të ofrimit.
- ofrojmë zgjidhje financiare optimale për klientë privatë të bankës bazuar në një qasje të "shërbimit të personalizuar".
- performojmë më mirë se industria sa i përket rritjes në kartelat e kredisë, rritjes që shtohet vazhdimisht me produkte dhe shërbime të reja, si dhe me kampanjat specifike të kartelave të organizuara me një grup tjetër të klientëve, anëtarët tanë tregtarë.
- ruajmë pozitën tonë të fortë në shërbimet menaxhuese të parasë së gatshme në shërbimet me pakicë.
- ofrojmë mbështetje bankare komerciale që është shtytësi kryesor në udhërrëfyesin drejt rritjes ekonomike të ardhme në Kosovë. Çdo vit, ne forcojmë fokusin tonë tashmë të fortë në mbështetjen e qindra mijërave klientëve komercialë dhe të NVM-ve të TEB-it, sepse ata luajnë rol në rritje të rëndësishëm për procesin e zhvillimit ekonomik.

Duke pasur parasysh këta faktorë, ne ishim të parët që prezantuar:

- një Sistem debiti direkt që i ndihmon kompanitë të ruajnë likuiditetin e tyre përmes një sistemi vetë-monitorues për të ulur kostot e tyre të financimit;
- një kartelë të kreditit me këste të quajtur Starcard që pati shumë ndikime në shumë nivele të shoqërisë në Kosovë: ajo ndihmoi në rritjen e konsumit, rritjen e qarkullimit të kompanive dhe në mënyrë indirekte ka mundësuar kufizimin e mëtejshëm të ekonomisë joformale të vendit.
- një Kartelë të kreditit Agro që iu mundëson fermerëve për të blerë inputet e tyre me këste përderisa rritet arkëtimi i parave të gatshme për tregtarët që i shesin ato inpute.

Si e bëjmë këtë

Si anëtarë të dy grupeve të fuqishme ndërkombëtare financiare – TEB A.S., institucion financiar kryesor dhe me reputacion të lartë në sektorin bankar turk dhe BNP Paribas, një nga bankat më të mira të Eurozonës me një rrjet të gjerë dhe ndërkombëtar – TEB-i përfiton nga përvoja, soliditeti dhe gama e Grupit. Kjo na mundëson të gjenerojmë rezultatet më të mira për klientët tanë.

Nga këto baza të shëndosha, TEB-i vazhdon të përparojë duke rritur cilësinë e shërbimeve të saj dhe duke zhvilluar produkte të përshtatura me pritjet e klientëve. Në hap me avancimet e shpejta në teknologji, në mënyrë sistematike ne përmirësojmë rrjetin tonë inovativ dhe me shumë kanale të shërbimeve bankare (si E-banking, Qendra e thirrjeve, Shërbimet SMS, Bankomatët, POS) duke iu lejuar klientëve të përdorin kanalin më të përshtatshëm të shpërndarjes për transaksionet e tyre bankare - në mënyrë të përshtatshme, të shpejtë dhe të besueshme.

Çka përfaqësojmë ne

Që kur TEB-i është themeluar në vitin 2008, ne kemi pasur pozicion udhëheqës. Si një bankë e fuqishme me shërbime të plota, ne jemi fokusuar në përgjigje ndaj kërkesës së klientëve për shërbime financiare. Me kalimin e viteve, ne kemi mundur të krijojmë kompetencat tona të korporatës dhe vizionin për të punuar në mënyrë efektive, duke dhënë vlerë të shtuar si për klientët ashtu edhe për aksionarët. Në vitin 2014, ne vazhduam të ndjekim rritjen tonë të balancuar dhe të shëndoshë – të pritshme tani - duke përforcuar më tej pozitën tonë si institucioni financiar më i fuqishëm në vend. Kjo na jep një bazë edhe më të fortë për të ardhmen tonë si një forcë e rëndësishme në Kosovë.

Përgjegjësia sociale e korporatës luan një rol të rëndësishëm. Politika jonë është të kontribuojmë në zhvillimin shoqëror të Kosovës. Ne kemi krijuar një kornizë për iniciativa afatgjate bazuar në rangun e projekteve që do të krijojnë përfitimet më të mëdha sociale. Këto

përfshijnë projekte si Kredia e gjelbër dhe Starcard-a e gjelbër dhe Kartela Agro. Në lidhje me mbështetjen e biznesit, ne jemi duke punuar përmes programit të mbështetjes së ndërmarrësisë të Grave, Akademisë së biznesit dhe Forumit të biznesit.

Angazhimet tona në fushën e sportit përfshijnë bashkëpunimin me Federatën e basketbollit të Kosovës dhe mbështetjen për turnirin e tenisit “Dielli TEB Open”. Kompanitë tona amë, TEB AS dhe BNP Paribas, tashmë janë sponsorë afatgjatë të turnirëve ndërkombëtarë të tenisit. Në fushën e arteve, ne jemi duke mbështetur filantropinë përmes sponsorizimit të projektit muzikor Hand-to-Hand. TEB-i është lidhur me Vihuela Guitar Festival që nga viti 2010 dhe ne jemi duke ofruar sponsorizim për një festival prestigjioz të videove muzikore.

TEB-i për klientët

TEB-i ia atribuon storien e saj të suksesit stafit tonë që përcjellin qasjen tonë inovative dhe proaktive të klientët, punojnë shumë për ta mbajtur dhe rritur cilësinë e shërbimeve dhe asetëve tona që emri ynë i përfaqëson. Qëllimet tona janë t’i ndihmojnë individëve dhe bizneseve që të ndërtojnë të ardhmen e tyre, të realizojnë ambiciet e tyre dhe t’iu ndihmojmë atyre të menaxhojnë rreziqet e tyre financiare. Ne duam të jemi një institucion financiar me të cilin klientët tanë ndihen rehat.

Me 25 degë, 53 banokomate, 3,500 Terminale të POS-it dhe ekipin tonë të menaxherëve të marrëdhënies, të cilët ofrojnë këshilla dhe shërbime të përshtatura për klientët tanë, ne besojmë se ky rrjet i gjerë vendor i ofrimit të shërbimeve është ai që e përkufizon shkallën dhe forcën e ofrimit të shërbimeve të TEB-it.

VIZIONI, MISIONI DHE STRATEGJIA JONË

Vizioni ynë

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë

Misioni ynë

Në vazhdimësi të krijojmë dhe të rrisim vlerë të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë tonë.

Strategjia jonë

Në përputhje me vizionin dhe misionin tonë, strategjia jonë është që të ofrojmë një përvojë të jashtëzakonshme dhe efikase bankare për të gjithë klientët tanë. Këtë do ta arrijmë duke ofruar produkte dhe shërbime inovative dhe praktike për të arritur rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Oferta e TEB-it është gjithmonë e bazuar në zotimin tonë për të qenë bankë e përgjegjshme. Kjo është e mishëruar në të gjitha vlerat tona dhe pasqyrohet në biznesin tonë, mënyrën se si ne zhvillojmë produktet dhe shërbimet tona dhe se si ne i paraqesim qëllimet dhe premtimet tona.

Ne veprojmë me integritet, jemi të hapur dhe të qartë, ne respektojmë njëri tjetrin, dhe jemi të përgjegjshëm nga ana sociale dhe mjedisore. Kjo përkthehet në:

Përktimi: 5 prioritetet kryesore strategjike



VLERAT TONA THEMELORE:

Vënien e klientit në qendër

Suksesi ynë është i bazuar në përkushtim të plotë për klientët tanë në çdo kohë, duke na dhënë besimin dhe besnikërinë e bazës sonë të klientëve. Ne e mbajmë atë besim duke i vendosur gjithmonë klientët tanë në qendër të çdo gjëje që e bëjmë. Nevojat dhe pritjet e klientëve janë shtytësit tanë përmes qasjes sonë të shpejtë dhe proaktive dhe përgjigjeve ndaj kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi. Kjo na mundëson të krijojmë dhe të japim vlerën e vërtetë ndërsa u shërbejmë klientëve tanë me shërbime dhe produkte të reja, që i tejkalojnë pritjet e tyre, të përshtatura dhe të trendit të fundit.

Integriteti

Ne kemi përqafuar standardet më të larta të integritetit në çdo gjë që themi dhe e bëjmë dhe jemi të përkushtuar për të krijuar vlerë të shtuar për klientët tanë, aksionarët dhe punonjësit duke bërë gjithmonë më shumë se vetëm atë që është e drejtë. Ne komunikojnë hapur dhe me ndershmëri, ftojmë dhe vlerësojmë pikëpamjet sfiduese që kanë për qëllim krijimin e ideve më të mira dhe marrjen e vendimeve më të përshtatshme dhe të balancuara.

Ne krijojmë vlerë për aksionarët tanë përmes suksesit afatgjatë dhe jo përmes fitimit afatshkurtër. Pra, qëllimi ynë është që biznesi ynë kryesor të ofrojë profitabilitet të shëndoshë dhe të fortë operativ dhe dividenda përmes një fryme të ndërmarrësisë që balancon rreziqet dhe kthimet me përgjegjësi.

Inovacioni

Ne kemi aspirata për inovacione që janë me rëndësi. TEB-i vlerëson entuziazmin të kombinuar me kureshtjen intelektuale në stafin tonë gjersa ata vazhdimisht synojnë të krijojnë produkte që do të lehtësojnë suksesin e klientëve tanë dhe do të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për nevojat e tyre.

Efikasiteti në punë

Ne krijojmë procese dhe produkte që janë të lehta për përdorim, të lehta për qasje dhe të projektuara për të shtuar vlerën. Ne përpiqemi për të siguruar që shërbimet që ofrohen për klientët tanë të jenë me çmim që barazohet në mënyrë të drejtë me koston aktuale të ofrimit të tyre.

Disiplina

Ne mendojmë dhe veprojmë si pronarë të Bankës, për të mbrojtur burimet e saj dhe për t'u përqendruar në qëllimet e përbashkëta dhe jo ato individuale. Ne jemi krenarë për sukseset e TEB-it dhe vlerën që krijojmë për aksionarët dhe klientët tanë. Secili nga 555 punonjësit tanë ndjehet përgjegjës në qoftë se dështojmë për të përmbushur pritjet e klientëve dhe jemi të gjithë përgjegjës për përmbushjen e premtimeve tona - nuk ka justifikime. Ne synojmë të arrijmë përsosmëri operative duke kryer punën mirë që në përpjekjen e parë.

Burimet njerëzore kompetente

Ne synojmë të forcojmë pozitën tonë si punëdhënës i zgjedhur dhe përpiqemi të krijojmë një kulturë që tërheq individë të talentuar, nxit punën ekipe bashkëpunuese ndërmjet personave të ndryshëm por prapë të përgjegjshëm dhe të shkathët, edukojmë dhe investojmë në talentet më të mira, dhe menaxhimin e bazojmë në merita dhe mundësitë e barabarta.

Partneriteti

Ne synojmë të kemi marrëdhënie të qëndrueshme dhe reciprokisht të dobishme me klientët dhe punonjësit në të cilat vlera e krijuar ndahet në mënyrë të drejtë. Ne jemi partnerë të përgjegjshëm me të gjitha palët e interesuara dhe rregullatorët, dhe i shërbejmë shoqërisë.

Kanalet e fuqishme të shpërndarjes

Ne përpiqemi për të ofruar shërbime dhe përkrahje për klientët tanë siç iu përshtatet atyre, duke ofruar kanale të ndryshme të shpërndarjes, duke përfshirë zyrat tona të degëve, qendrën e thirrjeve, shitjet e drejtpërdrejta dhe kanalet e ndryshme alternative të shpërndarjes.

STRUKTURA E AKSIONARËVE

Kapitali aksionar i Bankës është 24,000,000 € bazuar në 2,400,000 aksione të emetuara, secila me vlerë nominale 10 €.

Numri i aksioneve lidhet me aksione të zakonshme pa të drejta, preferenca ose kufizime të lidhura me to.

Struktura e pronësisë më 31 dhjetor 2014

Aksionarët më 31 dhjetor 2014	Kapitali i paguar për aksionet në pronësi (€)	Aksionet
TEB HOLDING A.S.*	24,000,000	100%

*50%-50% BNP Paribas Fortis Yatırımlar Holding A.Ş.dhe Çolakoğlu Group Joint Venture



Sukses

**SUKSESI YNË ËSHTË I BAZUAR NË
PËRKUSHTIM TË PLOTË PËR KLINTËT TANË
NË ÇDO KOHË, DUKE NA DHËNË BESIMIN DHE
BESNIKËRINË E BAZËS SONË TË KLIENTËVE.**



PASQYRA MAKROEKONOMIKE

RITMI I RITJES NË SHBA, DUKSHËM ËSHTË MË I LARTË NGA AI I ANTICIPUAR, NDËRSA RIMËKËMBJA NË EKONOMITË E TJERA TË MËDHA NUK ËSHTË DUKE I ARRITUR PARASHIKIMET

Çmimet më të ulëta të naftës do ta mbështesin rritjen globale në vitin 2015, por divergjencat e rritjes në ekonomitë kryesore do të mbesin evidente. Faktorët negativë, duke përfshirë dobësimin e investimeve si rregullim për pritjet e zvogëluara për rritjen afat mesme vazhdojnë në shumë ekonomi të tregut të avancuara dhe në zhvillim. Pritjet e rritjes së ngadalshme afat mesme vazhdojnë në shumë ekonomi të tregut të avancuara dhe në zhvillim.

Ritmi i rritjes në SHBA ka qenë më i lartë nga ai i anticipuar ndërsa e njëjta nuk mund të konstatohet për sa i përket rimëkëmbjes në ekonomitë

tjera të mëdha pasi që të njëjtat nuk janë duke i arritur parashikimet. Në mënyrë që të arrihet ekuilibër mes ekonomive të mëdha, FED pritet të angazhohet në një cikël të ngritjes së normave të interesit duke filluar nga Shtatori. Kjo ngritje parashihet të realizohet në mënyrë graduale në kuadër të politikës restrictive monetare.

Në anën tjetër, performanca ekonomike në të gjitha ekonomitë e tjera kryesore është larg pritjeve. Aktiviteti ekonomik në zonën e euros do të mbështetet nga çmimet e ulëta të naftës, programi mjaft i gjerë i QE-së (quantitative easing) i Bankës

Qendrore Evropiane, një euro më e dobët dhe një qëndrim fiskal më neutral. Rënia e pritur në inflacion nga 0.2% v/v në TM4 në - 0.6% v/v në TM1 duhet të sjellë 0.8pp fitim në rritjen reale të kompensimit në Eurozonë nga 2% v/v në Gj2 2014. Fitimet në fuqinë blerëse të nxitura nga çmimi i naftës nuk janë efekte të përhershme të të ardhurave, sepse ato do të zbehen kur inflacioni të rikthehet për shkak të efekteve me bazë energjinë, prandaj do të jepnin vetëm një rritje të përkohshme. Ribalancimi në Eurozonë gjithashtu nënkupton se jo të gjitha fitimet e të ardhurave pasojnë përmes konsumit. Megjithatë, perspektivat më të dobëta të investimeve dhe rreziqet politike mund t'i kompensojnë këta faktorë. Rënia në çmimin e naftës ka qenë një dhuratë nga perëndia për Japoninë. Megjithatë, për BoJ në

kërkimin e saj për të arritur objektivin e bankës për inflacion prej 2%, kjo nuk ka qenë aq ideale, sepse stimuli ekonomik i çmimeve të ulëta të naftës do të vijë me koston e inflacionit të ulët. Stagnimi dhe inflacioni i ulët janë ende shqetësime në zonën e euros dhe në Japoni. Ngadalësimi i rritjes kineze do të jetë gjithashtu një zvarritje në tregjet në zhvillim, veçanërisht në Azi. Me dobësimin e mundshëm të mëtejme të Euros dhe jenit japonez, tempo e lehtësimit të politikave në të gjithë Azinë ka të ngjarë të vazhdojë për të kompensuar vlerësimin real të valutës, inflacionin në rënie dhe rritjen e ngadaltë. Për më tepër, me rritjen e normave nga Fed-i, flukset e kapitalit në tregjet në zhvillim të viteve të fundit mund ta ndryshojnë kursin, dhe shkaktojnë episode të luhatshmërisë në tregjet në zhvillim.

LETËR NGA KRYESUESI

Të nderuar klientë, partnerë të biznesit dhe aksionarë,

TEB Sh.A ka ambicie që të jetë banka më e mirë në Kosovë. Në përputhje me këtë ambicie, Banka është bazuar në qëndrueshmërinë, përvojën dhe ekspertizën e kompanive amë të saj për të krijuar burime të konsiderueshme për ekonominë e Kosovës.

Viti raportues, 2014, ka qenë një periudhë aktive në ekonominë globale. Pavarësisht nga sfidat, parashikimet tregojnë se ekonomia evropiane do të vazhdojë të rritet. Nga ana tjetër, tregjet në zhvillim që pas krizës globale financiare të vitit 2008 kishin qenë shtytësit e rritjes globale, duket se kanë humbur pak nga vrulli dinamik.

Sipas Bankës Qendrore Evropiane (BQE), norma mesatare e inflacionit në Eurozonë në vitin 2014 ka rënë në 0.4 për qind. Gjatë vitit 2014 dhe mbështetur nga çmime më të ulëta të naftës, klientët rifituan besimin dhe shkalla e papunësisë ndaloi së rrituri në eurozonë. Si rezultat i kërkesës më të madhe të brendshme dhe të jashtme, ne presim që qasja në financa të përshpejtohet.

Nga perspektiva e Kosovës, vazhdimësia e rritjes ekonomike në vitet e fundit i ka mundësuar vendit për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe ka gjeneruar një normë mesatare rritjeje të PBV-së prej 3.3%. Megjithatë, përkundër shumë mundësive për investime, si dhe mungesës së konkurrencës së fortë në sektorë të caktuar, klima e biznesit në Kosovë mbetet sfiduese.


TEB Sh.A ishte në gjendje për të mbajtur performancën e saj të fuqishme në vitin 2014 me anë të menaxhimit të suksesshëm të bilancit të gjendjes, strukturës së aseteve me cilësi të lartë, nivelit të qetë të

likuiditetit dhe bazës së fortë të kapitalit. Si TEB Sh.A, kemi adoptuar një qasje të balancuar që gjithmonë merr parasysh ndërveprimin e rrezikut, kthimit, kapitalit dhe likuiditetit. Sa i përket strukturës së saj financiare, TEB Sh.A ka shmangur politikat agresive të rritjes që do të kishin një ndikim leve në bilancin e saj. Në vend të kësaj, Banka ka shfaqur sistematikisht një qasje më të kujdesshme se kurrë në menaxhimin e rrezikut.

Përveç një performancë të fortë operacionale dhe financiare, në vitin 2014 TEB Sh.A gjithashtu ka vazhduar dhe shkallëzuar aktivitetet e saj në bazë të parimit tonë të "dhënies së kontributit prapa në shoqëri". Ne do të vazhdojmë të bëjmë më të mirën tonë në përputhje me motivimin dhe përgjegjësinë tonë për të kontribuar në arsim, mjedis, kulturë, art dhe sport, për ta ndihmuar shoqërinë tonë - në të cilën jetojmë dhe të cilës i kemi borxh shumë - që të lëvizë një hap më tej.

TEB Sh.A gjithashtu vazhdon të kombinojë avantazhin konkurrues me aftësinë e korporatës në një shkallë optimale për të prodhuar vlerë të shtuar ndërsa ne interpretojmë dhe përkthejmë nevojat bankare dhe sociale të komunitetit.

Nuk ka asnjë dyshim se forca më e rëndësishme pas përfundimit të suksesshëm të këtij viti është kompetenca, besnikëria dhe përpjekjet e dedikuara të punonjësve dhe menaxherëve tanë. Së fundi, unë do të doja t'iu shpreh mirënjohjen time kolegëve të mi, aksionarëve tanë, klientëve tanë të çmuar, partnerëve dhe të gjitha palëve të interesit.



Musa Erden

Kryesues i Bordit të Drejtorëve



**TEB SH.A - NJË NGA
INSTITUCIONET MË
TË RRËNJOSURA
THELLË NË SEKTORIN
BANKAR TË KOSOVËS
KA VAZHDUAR
QASJEN E SAJ TË
QËNDRUESHME ME
FOKUS NË KLIENTIN
NË VITIN 2014**

LETËR NGA KRYESUESI I BORDIT



“QASJA ME FOKUS NË KLIENTIN PËR SHËRBIMET BANKARE” E TEB SH.A. KA VAZHDUAR ME SHPEJTËSI TË PLOTË GJATË VITIT 2014; OFRIMI I PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE TONA I MUNDËSON BANKËS TË VIJË GIJTHNJË E MË AFËR KLIENTËVE TANË

Të nderuar klientë, partnerë të biznesit dhe aksionarë,

Kjo periudhë e vitit është koha më e përshtatshme për të shikuar prapa në vitin që kemi lënë pas dhe të gjitha zhvillimet që e cilësuan atë në aspektin lokal dhe global. Viti 2014 ishte pa dyshim një vit sfidues për ne. Paqëndrueshmëria e çmimeve të naftës dhe ndikimi i përgjithshëm që kjo pati në zhvillimet globale solli shumë paqartësi ekonomike edhe në tregjet tona lokale.

Ekonomia e Kosovës ka treguar progres të konsiderueshëm në tranzicionin në një sistem të tregut dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, por ajo gjithashtu është ende e varur nga ndihma financiare dhe teknike e bashkësisë ndërkombëtare dhe remitancat nga diaspora.

Kosova ka shënuar një normë mesatare rritjeje të BPV-së prej 3.3% gjatë viteve të fundit, duke e bërë atë një nga vendet e pakta në rajon me rritje pozitive, me gjithë krizën e Eurozonës. Unë jam i kënaqur të them në këtë moment të veçantë se pavarësisht nga pasiguritë ekonomike, TEB Sh.A ka demonstruar një rritje të shpejtë në rezultatet e saj të përgjithshme për vitin 2014, duke e dëshmuar veten si një bankë me një bazë të shëndoshë për zhvillim të qëndrueshëm. Ajo që më bën të ndihem shumë i kënaqur është se banka ka arritur rezultatet e saj të jashtëzakonshme financiare jo vetëm nëpërmjet aktiviteteve të saj kryesore bankare komerciale, por përveç kësaj ka sjellë në treg disa risi, si:

Programi i Grave Ndërmarrëse që promovon qasjen në financa për gratë në biznes,

Akademitë e biznesit për klientët tanë të NVM-ve që promovon bankën tonë si i vetmi ofrues i shërbimeve jo-financiare në treg,

Programi i Efiçencës së Energjisë që mundësoi që shumë klientë tanë me pakicë dhe të NVM-ve të rinovojnë pajisjet e tyre efiçente në energji, duke ndikuar drejtpërdrejtë në faturat e tyre të energjisë, dhe shumë aktivitete të tjera të ndërlidhura që drejtpërsëdrejti ndikojnë në mirëqenien ekonomike në treg.

TEB Sh.A ka për qëllim që të bëhet një nga akterët më shembullor në sektorin bankar nëpërmjet rezultateve tona të suksesshme financiare dhe performancës së shëndoshë të rritjes, si dhe përmes aktiviteteve tona me përgjegjësi shoqërore. TEB Sh.A renditet në tre të parat në aspektin e portofolit të kredive të papaguara. Ne jemi një nga lojtarët më të mirë në shërbimet bankare me pakicë dhe kemi shumë arritje të njohura në biznesin e kartelave të kredisë. Në aspektin e risive të biznesit, ne kemi qenë të parët në treg me gamën e gjerë të produkteve që jo vetëm kanë zgjeruar potencialin e biznesit të NVM-ve, por kanë ndryshuar edhe sjelljet dhe fuqinë blerëse të individëve, duke ndihmuar të rritet ekonomia e Kosovës. Qasja jonë e qeverisjes korporative, të cilën ne e ruajmë me kujdesin maksimal, dhe politikat tona të matura të menaxhimit të rrezikut kanë kontribuar më tej në një vit shumë të suksesshëm.

Para së gjithash, unë do të doja të falënderoj punonjësit tanë, të cilët janë shtytësit më të mëdhenj pas këtyre sukseseve; më pas, aksionarët tanë dhe klientët tanë, të cilët i kanë besuar TEB Sh.A, dhe të gjitha palët tona sociale dhe ekonomike të interesit. Faleminderit për një vit frymëzues.

Ayhan Albeyoglu
Drejtori Menaxhues

Inovacioni

**NE KEMI ASPIRATA PËR INOVACIONE QË JANË
ME RËNDËSI. TEB-I VLERËSON ENTUZIAZMIN TË
KOMBINUAR ME KURRESHTJEN INTELEKTUALE NË
STAFIN TONË GJERSA ATA VAZHDIMISHT SYNOJNË
TË KRIJOJNË PRODUKTE QË DO TË LEHTËSOJNË
SUKSESIN E KLIENTËVE TANË.**



VËSHTRIM I SHPEJTË PËR VITIN 2014

1) Lansimi i Kredisë së gjelbër

TEB Sh.A vendos standarde të larta kur bëhet fjalë për ndikimin e veprimtarive të saj në mjedis. Në vitin 2014, banka rriti bashkëpunimin e saj me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) duke prezantuar “Kredinë e gjelbër”.

Kredia e gjelbër e TEB-it është e projektuar për të mbështetur financiarisht klientët individual (rezidencial) dhe klientët e biznesit në investime që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit të energjisë. Ne ishim të parët që prezantuam këtë lloj të produktit, në bashkëpunim me BERZh-in. Huamarrësit mund të përdorin kredinë për të bërë investime që kursejnë energjinë dhe që janë miqësore për mjedisin, që do t'i reduktojnë faturat e tyre të energjisë dhe gjurmët. Kredia mund të përdoret vetëm për projekte që do të kontribuojnë në përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave të banimit dhe për të promovuar përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme. Ky produkt gjithashtu promovon përdorimin e produkteve me konsum të ulët të energjisë që nxisin përdorimin e burimeve alternative të energjisë. Ky produkt është i veçantë sepse e kthen deri në 20% të shumës së kredisë të të gjithë klientët që i plotësojnë kriteret e çdo projekti.

Përmes këtij projekti, TEB-i synon të rrisë ndërgjegjësimin e përdorimit të duhur të energjisë dhe në të njëjtën kohë t'i informojë ata për përfitimet e përdorimit të produkteve miqësore për mjedisin.

2) Kartela Agro

Kartela e kredisë Agro e para në Kosovë

TEB-i, në partneritet me USAID-in, ka nisur Kartelën e kredisë Agro, të parën ndonjëherë në Kosovë, e cila është produkti më i ri bankar për qëllime të agrobiznesit.

Kartela Agro është produkti më i fundit i Bankës që mbështet agrobizneset kosovare dhe blerjet nga fermerët të produkteve hyrëse bujqësore dhe pajisjeve. Kartela ofron këste pa interes dhe një periudhë mospagimi deri në gjashtë muaj. Kartela Agro me sukses kombinon të tre pikat në trekëndëshin ekonomik të sektorit: fermerët, tregtarët dhe Bankën. Duke sjellë të tre së bashku në një trekëndësh të virtutshëm, të gjithë gëzojnë përfitime. Në kulmin e sezonit, ajo gjithashtu iu ofron fermerëve mundësinë për të bërë blerje me një periudhë mospagimi prej gjashtë muajsh dhe pa interes. Në anën tjetër, tregtarët garantojnë pagesat e tyre dhe si rezultat i kësaj, ata rritin shitjet. Duke qenë në mes të këtyre proceseve, Banka administron rrjedhën e parasë tek fermerët dhe tregtarët.

3) Banka mbështet projektin Hand-to-Hand

Ky projekt është një iniciativë e Filantropëve të Kosovës, një organizatë jo-fitimprurëse e përkushtuar për të ndihmuar jetimët, fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët e të gjitha nacionaliteteve në Kosovë, të cilët jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Organizata ka për qëllim të veprojë si zë për çështjet sociale në Kosovë. Për këtë arsye kënga Hand-to-Hand është veçanërisht e qëlluar sepse është një këngë që është bërë himni i kampit veror të organizuar për fëmijët në nevojë. Kënga është në gjuhën angleze për të arritur një numër të madh të audiencës (ndërkombëtare), me qëllim të krijimit të programeve të shkëmbimit dhe aktiviteteve të përbashkëta për fëmijët. Si kënga ashtu edhe video shoqëruese janë promovuar në të gjitha mediat në Kosovë dhe nëpërmjet rrjeteve sociale.

PËRMES PROJEKTIT TË KREDISË SË GJELBËR, TEB-I SYNON TË RRISË NDËRGJEGJËSIMIN E PËRDORIMIT TË DUHUR TË ENERGJISË DHE T'I INFORMOJË ATA PËR PËRFITIMET E PËRDORIMIT TË PRODUKTEVE MIQËSORE PËR MJEDISIN.

4) TEB-i dhe Video Fest-i - festival prestigjioz i videove muzikore

Qëllimi i këtij festivali është që të promovojë dhe të stimulojë zhvillimin e artistëve dhe prodhuesve të videove muzikore nga të gjithë trojet shqiptare - Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe diaspora. Duke e sponsorizuar këtë festival prestigjioz, TEB-i ndihmon për të sjellë së bashku të gjithë ata që kanë interes për art dhe kulturë.

5) Bashkëpunimi me Federatën e Basketbollit të Kosovës (sponsorizimi për kategoritë e të rinjve)

TEB-i ka nënshkruar një Memorandum të Bashkëpunimit me Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), duke u bërë kështu sponsori i saj zyrtar për të gjitha kategoritë, veçanërisht të rinjtë. Ne e shohim këtë bashkëpunim si mënyrë për të investuar në rininë e sotme duke mundësuar zhvillimin e programeve të basketbollit për gjeneratat e reja. Qëllimi ynë është për të ndihmuar lojtarët e rinj të bëhen liderë në fushë dhe në jetë. Ne duam t'u japim atyre modele për të ndjekur, duke theksuar rëndësinë e punës ekipore dhe të lojës së ndershme dhe gjithashtu për të stimuluar arsimimin, për të ndërtuar karakterin dhe vendosmërinë për të arritur sukses në jetë.

6) Shërbimi për turneun e tenisit "Dielli TEB Open"

Angazhimi i TEB-it për rininë kosovare përfshin një shërbim të shëndoshë të sponsorizimit të sportit. Përveç basketbollit, TEB-i është duke mbështetur edhe tenis. Ka shumë lojtarë të talentuar në Kosovë dhe turneu i ri iu jep të rinjve mundësi për të përjetuar një ngjarje të klasit të lartë. TEB-i ka mbështetur turneun e tenisit "Dielli TEB Open" për pesë vitet e fundit. Ky turne shënoi edicionin e tij të 13-të vitin e kaluar, por stimujt nga banka e kanë rritur vlerën dhe profesionalizmin e tij.

7) Festimi i futbollit ndërkombëtar - TEB-i organizon mirëpret ekipe nga Franca dhe Zvicra

Në qershor, TEB-i organizoi një pritje për t'iu uruar mirëseardhje lojtarëve të ekipit kombëtar të futbollit francez dhe zviceran në Kosovë për një ndeshje ndërkombëtare. Ndër të ftuarit, ishin Drejtori i përgjithshëm i Bankës TEB - z. Ajhan Albeyoglu; Ambasadorja e Francës në Kosovë, znj. Maryse Daviet; dhe klientët e korporatave të Bankës TEB.

8) Inicimi i Programit për mbështetjen e Grave ndërmarrëse

TEB-i fuqimisht beson se idetë e vlefshme të biznesit meritojnë mbështetje, sidomos nëse ato vijnë nga gratë e Kosovës. Kjo është arsyeja pse në bashkëpunim me Gjakova Innovation Center, TEB-i është duke mbështetur gratë ndërmarrëse për të zbatuar idetë e tyre të biznesit. Ne do ofrojmë ndihmë në organizimin e ngjarjeve për gratë me ide të reja dhe ambicie për të hapur biznese të reja. Dhe përmes programit, gratë ndërmarrëse do të kenë qasje në kartelat Agro për t'iu ndihmuar atyre që të arrijnë qëllimet e tyre. Kjo është plotësisht në përputhje me qëllimin tonë të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve që më së miri i përshtaten kërkesave dhe nevojave të klientëve.

9-) Akademia e Biznesit

Akademia e Biznesit është një ngjarje ditore, që përfshinë leksione dhe seminare për mysafirët e Bankës. Ajo mbuloi tema të ndryshme për të mbështetur rritjen e korporatave, me prezantime nga dhe ndërveprime me profesionistë të mirënjohur nga Turqia dhe Kosova

TEB-I NË SHIFRA

TEB në shifra ('000 Euro)

	2014	2013	Rritje/(Rënie)	Përqindja
Indikatorët e bilancit të gjendjes				
Gjithsej asetet	369,343	372,401	(3,058)	-0.8%
Gjithsej kreditë (bruto)	312,421	283,094	29,327	10.4%
Depozitat	314,353	327,232	(12,879)	-3.9%
Kapitali i aksionarëve	35,655	26,394	9,261	35.1%
Kreditë joperformuese/Gjithsej kreditë	7.3%	6.5%	0.8%	12.1%
Kreditë/Gjithsej asetet	84.6%	76.0%	8.6%	11.3%
Raporti i mbulimit të kredive joperformuese	93.5%	80.5%	13.1%	16.2%
Indikatorët e pasqyrës së të hyrave				
Të hyrat neto nga interesi	28,360	20,889	7,471	35.8%
Të hyrat neto jo nga interesi	5,744	5,099	645	12.6%
Raporti kosto/të hyra	46.2%	55.1%	-8.9%	-16.1%
Neto të hyrat bankare	34,407	26,295	8,112	30.8%
Neto fitimi vjetor	9,261	3,786	5,475	144.6%

84.6% 93.5%

KREDITË/GJITHSEJ ASETET në
vitin 2014

RAPORTI I MBULIMIT TË KJP-ve
në vitin 2014

TEB në shifra ('000 Euro)

	2014	2013	Rritje/(Rënie)	Përqindja
Raportet e profitit				
Kthimi në ekuitet	36.2%	17.7%	18.6%	105.1%
Kthimi në asete	2.5%	1.0%	1.5%	146.6%
Të hyrat neto nga interesi/ Asetet mesatare që krijojnë interes	9.5%	8.0%	1.5%	18.7%
Raportet e likuiditetit				
Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit	15.6%	13.4%	2.2%	16.0%
Asetet likuide/Gjithsej asetet	20.4%	26.8%	-6.4%	-24.0%
Asetet e peshuara sipas rrezikut	321,590	287,140	34,450	12.0%
Indikatorët e tjerë				
Degët	25	26	(1)	-3,8%
Punonjësit	598	555	43	7.7%

36.2% 15.6%

KNE në vitin 2014

RMK në vitin 2014

INDIKATORËT KYÇË FINANCIARË

Kombinimi i angazhimit të TEB-it për menaxhimin e kujdesshëm të portofolit, menaxhimi i balancuar mirë i rrezikut në përputhje me një strategji të shëndoshë të rritjes, dhe kënaqësia e vazhdueshme e klientëve tanë kanë rezultuar në fitime të jashtëzakonshme, një rritje të qëndrueshme në portofolion e kredisë dhe një rritje të mëtejshme në pjesën e tregut në vitin 2014.

Në fund të vitit 2014, totali i aseteve të Bankës arriti 369.3 milion €, duke rënë për 3.1 milion € ose 0.8% në krahasim me vitin 2013, por në aspektin e madhësisë së aseteve, duke mbetur në nivelin e synuar. Portfolio bruto e kredive u rrit në 312.4 milion €, një rritje prej 10.4%, ose një rritje e volumit prej 29.3 milion € mbi performancën e vitit të kaluar dhe që përfaqëson rritjen më të lartë të kredive në sektorin bankar në vitin 2014. Kreditë bruto tani përbëjnë 85% të totalit të aseteve të Bankës në bilancin e gjendjes të TEB-it.

Në fund të vitit 2014, raporti i kredive jo performuese (KJP) (kreditë mbi 90 ditë në vonesë) ishte 7.3%, krahasuar me 6.5% në vitin 2013, një rritje prej 80 pikëve bazë. Depozitat totale të klientëve në

fund të vitit 2014 arritën në 314.4 milion €, një rënie prej 12.9 milion € ose 3.9% në krahasim me fundin e vitit 2013.

Një marrëveshje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për nën-financimin e projekteve të efijencës së energjisë në shumë prej 5 milion € është nënshkruar gjatë vitit 2013, nga të cilat 2.5 milion € janë marrë nga BERZh-i gjatë vitit raportues.

Kapitali aksionar është rritur nga 26.4 milion € në vitin 2013 në 35.7 milion € në vitin 2014, për shkak të rritjes së fitimeve të mbajtura gjatë vitit. Në tërësi, kjo paraqet një rritje prej 35.1% në kapitalin e aksionarëve në krahasim me vitin 2013.

Indikatorët e pasqyrës së të ardhurave gjithashtu tregojnë përmirësim të dukshëm në performancë në krahasim me vitin e kaluar. Të hyrat neto nga interesi arritën 28.4 milion €, duke u rritur për 7.5 milion € ose 35.8% në krahasim me vitin 2013, me gjithë trendin e vazhdueshëm të rënies në normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita gjatë vitit 2014. Të hyrat neto jo nga interesi kanë arritur në 5.7 milion €, një rritje prej 0.6 milion € ose 12.6% në krahasim me vitin 2013.

9.3 milion €

BANKA PËRFUNDOI VITIN
ME 9.3 MILION € FITIM PAS
TATIMIT NË VITIN 2014

Raporti kosto të ardhura në vitin 2014 është ulur më tej në 46.2% nga 55.1% në vitin 2013, duke treguar rritjen e efikasitetit të Bankës dhe menaxhimin e vazhdueshëm të kujdesshëm të shpenzimeve operative. Të hyrat neto nga shërbimet bankare në fund të vitit ishin 34.4 milion € në krahasim me 26.3 milion € të realizuara në vitin 2013.

Banka përfundoi vitin me 9.3 milion € fitim pas tatimit në krahasim me 3.8 milion € në vitin 2013, ose një rritje prej 144.6%.

Sa i përket indikatorëve të profitabilitetit, në fund të vitit 2014 Banka ka gjeneruar kthim në ekuitet (KNE) me rentabilitet prej 36.2% krahasuar me 17.7% në vitin 2013, ndërsa kthimi në asete (KNA) qëndroi në 2.5% në krahasim me 1% në vitin paraprak. Raporti i Interesit neto mbi Asetet mesatare që krijojnë interes ishte 9.5% krahasuar me 8.0% në vitin paraprak. Sa i përket menaxhimit të

kapitalit të bankës në fund të vitit 2014, Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit i Bankës (RMK) ishte 15.6%, duke tejkaluar kërkesën minimale të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) prej 12%, dhe është rritur nga 13.44% në fund të vitit 2013 për shkak të rritjes së fitimeve të mbajtura gjatë vitit.

Raporti i Aseteve likuide në krahasim me asetet totale ishte 20.4% në fund të vitit 2014 në krahasim me 26.8% në vitin 2013, ndërsa Asetet e vlerësuara sipas rrezikut (AVRr) arritën 321.6 milion €, të rritura nga 287.1 milion € në vitin paraprak pas rritjes në portfolion e kredive gjatë vitit 2014.

Në vitin 2014, Banka mbylli një degë, duke ulur numrin e përgjithshëm të degëve në 25 (2013: 26), ndërsa numri i punonjësve është rritur në 598 në krahasim me 555 sa ishin në fund të vitit 2013.

SHËRBIMET BANKARE PËR INDIVIDË

Duke përdorur qasjen tonë me fokus në klientin, TEB Sh. A ofron një gamë të plotë të shërbimeve dhe produkteve që iu duhen personave në faza të ndryshme të jetës

Klientët janë shtytësit pas misionit kryesor të Shitjes me pakicë të shërbimeve bankare - për të mbështetur dhe financuar familjet dhe klientët individual. Ne synojmë të jemi partnerë të vërtetë për klientët tanë të shitjes me pakicë dhe t'i ndihmojmë ata të përparojnë, sepse ata qëndrojnë prapa rritjes së ardhshme dhe punësimit. Ne e bëjmë këtë pjesërisht duke ofruar shërbime të shkëlqyera, si në degë ashtu dhe nëpërmjet kanaleve tona të ebanking-ut, dhe duke fituar dhe ruajtur besnikërinë dhe besimin e klientëve.

Besimi i klientëve – pasuria jonë më e vlefshme

Besimi dhe besnikëria e klientëve tanë janë asetet tona më të vlefshme. Besimi i tyre nuk është i rastit; ne kemi investuar dhe vazhdojmë të investojmë shumë në ndërtimin dhe ruajtjen e atij besimi gjatë viteve. TEB-i synon të fitojë besnikërinë e klientëve të cilët presin një marrëdhënie të personalizuar, njohjen e besnikërisë së tyre dhe qasje optimale në Bankë. Kjo synohet edhe për klientët të cilët po ndërtojnë asetet e tyre personale dhe të cilët potencialisht mund të bëhen klientë të menaxhimit të pasurisë. Në mjedisin e tanishëm bankar, zhargoni dhe terminologjia e sektorit janë zakonisht norma gjatë komunikimit me një bankë. Ne mbrojmë komunikimin përmes dialogut të bazuar në transparencë, ndershmëri, këshilla të paanshme dhe informacion të paanshëm dhe të sigurtë. Ne e bëjmë këtë në gjuhë të drejtpërdrejtë, duke fuqizuar klientin për të marrë vendime të informuara. Këtë vit, hynë në fuqi ligjet dhe rregullat e reja për aktivitetet bankare. Përveç që i jemi përgjigjur të gjitha rregulloret të reja, ne kemi mbajtur klientët tanë të informuar për ndryshimet dhe pasojat praktike në aktivitetet bankare.

Inovacioni - përmbushja e nevojave të vërteta të klientëve

Inovacioni gjithmonë ka luajtur një rol qendror në TEB dhe kjo reflektohet në moton tonë: "Bankë për një botë në lëvizje". Në veprimtaritë bankare me pakicë, inovimi do të thotë të kuptuarit e ndryshimit dhe pritjeve të klientëve dhe gjetje e zgjidhjes përballë teknologjisë së re dhe akterëve të rinj. Inovimi gjithashtu do të thotë planifikim dhe të qenit proaktiv. Në një mjedis me kriza dhe pabarazi në rritje, kompanitë dhe institucionet financiare mund ta ndihmojnë nxitjen e përparimit nëpërmjet angazhimit të tyre dhe rolit në shoqëri. Shumë iniciativa të ndërmarra nga Shërbimet bankare me pakicë në vitin 2014 tregojnë këtë angazhim në veprim. Gjatë vitit, ne kemi nisur një numër fushatash që ofruan norma të volitshme dhe konkurruese, të përshtatura për nevojat e klientëve. Në partneritet me shkollat dhe universitetet, ne kemi prezantuar Kreditë për Arsim për financimin e pagesës së shkollës pa interes për studentët. Ne tani ofrojmë kredi hipotekare me norma shumë të volitshme të interesit dhe me maturitet të përshtatur me të ardhurat e klientëve. Kjo do të thotë se pagesat nuk e mbingarkojnë buxhetin shtëpiak. Në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), ne kemi prezantuar një produkt kreditor të gjelbër. Produkti është përshtatur për të financuar projekte të cilat do ta përmirësojnë eficiencën e energjisë. Normat e interesit janë shumë të volitshme dhe klientët që marrin këto kredi kanë të drejtë për stimulim financiar nga BERZh-i. Klientëve të shërbimeve me pakicë u janë ofruar kredi konsumuese që fillojnë pa interes dhe i mundësojnë atyre që të financojnë nevojat e tyre personale, duke përfshirë pajisjet shtëpiake, automjetet dhe projekte të tjera që kontribuojnë në mirëqenien e tyre. Për më tepër, ne vazhdojmë të ofrojmë mundësi të tilla si pushim nga pagesa për klientë të caktuar. Ne besojmë se të gjitha këto inovacione tregojnë se jemi bankë me vendosmëri me fokus në klientin.

TEB-i - DUKE NDËRMARRË HAPA TË SHËNDOSHË PËR TË RRIUR PJESËN E VET NGA MUNDËSITË E RRIJTJES TË OFRUARA NGA TREGU.

+37,000

NË VITIN 2014, NE FITUAM BESIMIN E MË SHUMË SE 37,000 KLIENTËVE TË RINJ, QË PARAQET NJË RRIJTJE PREJ 20% KRAHASUAR ME VITIN 2013

TEB-i - duke ndërmarrë hapa të shëndoshë për të rritur pjesën e vet nga mundësitë e rritjes të ofruara nga tregu Performanca jonë këtë vit

Viti raportues, 2014-ta, ishte një tjetër periudhë e suksesshme për aktivitetet tona të shërbimeve bankare me pakicë, me shërbim të cilësisë së lartë që ka luajtur një rol kyç në tërheqjen e klientëve të rinj dhe mbajtjen e klientëve ekzistues. Ne ishim në gjendje të rrisim besnikërinë e klientëve duke zbatuar aplikime novatore në Kosovë, dhe duke përmirësuar kënaqësinë e klientëve me strukturën tonë inovative dhe dinamike.

Misioni ynë në vitin 2014 ishte që të vazhdojmë të shtojmë produkte dhe shërbime inovative për sektorin bankar me pakicë. Qëllimi ynë ishte ofrimi i produkteve miqësore për përdoruesin, udhëheqëse dhe inovative për klientët tanë të shitjes me pakicë, që i ndihmojnë ata të arrijnë ambiciet e tyre - në mënyrën e duhur. Rritja jonë e vazhdueshme tregon se kemi qenë të suksesshëm. Në vitin 2014, ne kemi fituar besimin e më shumë se 37,000 klientëve të rinj, që paraqet rritje prej 20% krahasuar me vitin e kaluar. Duke i shërbyer klientëve tanë me produkte krijuese dhe ide, ne kemi arritur një portofol të kredisë së papaguar prej 15.9 milion € ose një rritje prej 21% në vitin 2013. Portofoli i kredive hipotekare në fakt u rrit me 66% dhe portofoli i kredisë për Automjete pothuajse u dyfishua (u rrit për 98%). Ne kemi prezantuar Kredinë e gjelbër, ofertë e parë ndonjëherë e sektorit bankar të Kosovës për t'u mundësuar klientëve që të reduktojnë konsumin e tyre të energjisë, dhe si rrjedhim kostot e ndërlidhura. Në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), TEB-i i ka dhënë mundësi klientëve që të investojnë në eficientësi të energjisë, duke fituar një nxitje 20%. Në vitin 2014, TEB-i ka lëshuar një total prej 1.6 milionë € në Kredi të gjelbra.

Programi i Private Banking i filluar në vitin 2014 ofron produkte dhe shërbime për klientët në segmentin e sipërm të

shitjes me pakicë dhe familjet e tyre, bazuar në konceptin e shërbimit të "privilegjuar". Ashtu si të gjitha shërbimet e TEB-it, programi Private Banking është i projektuar për të përmbushur nevojat specifike të jetesës të këtij segmenti të klientëve. Ne gjithmonë kemi për qëllim të tejkalojnë pritjet e tyre të cilësisë së shërbimit.

Shërbimi personal, duke përfshirë këshilla dhe ndihmë, është çelësi për ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me të gjithë klientët tanë të shitjes me pakicë. Ne kemi një rrjet të degëve ku klientët mund të trajtojnë transaksionet "në sportel". Por ne gjithashtu duam t'i bëjmë shërbimet bankare dhe menaxhimin e financave të përshtatshëm. Ne kemi investuar shumë në opsionet e e-banking. Vizita në degë ose qëndrimi në rend për të kryer transaksionet e përditshme nuk është më i nevojshëm. Dhe klientëve tanë ju pëlqen të kenë zgjidhje. Krahasuar me vitin 2013, 43% klientë më shumë kanë përdorur platformën tonë të e-banking. Përdoruesit e rinj të SMS Top-up u rriten me 7%, dhe përdoruesit e SMS Banking u rriten me 10%.

Çka më tutje?

Për t'i shërbyer klientët tanë me produkte dhe shërbime të reja dhe plotësuese dhe për të mbështetur rritjen tonë, në vitin 2015 dhe më tej, ne do të vazhdojmë rivlerësimin në mënyrë sistematike të veprimtarisë bankare digjitale dhe mobile për të shfrytëzuar potencialin në popullatën e re të Kosovës. E re në shërbimet tona të Private Banking do të jetë qasja jonë inovative në Shërbimet bankare individuale. Ne do të vazhdojmë të ofrojmë përvoja të shkëlqyera për klientët dhe të vendosim bazat për të ardhmen. Ne do të vazhdojmë gjithashtu të shtojmë kanalet tona të besueshme dhe inovative alternative të shpërndarjes për t'u shërbyer nevojave të përditshme bankare të klientëve. Në të njëjtën kohë, ne do të ndajmë më shumë resurse për rritjen e degëve për cilësi superiore të shërbimit dhe përkrahje këshilluese me vlerë të shtuar.

BIZNESI I KARTELAVE

Ne jemi kudo që klientët tanë janë

Me mbi 20,000 kartela të reja të miratuara gjatë vitit 2014, Starcard-a mbetet kartela e kredisë më e preferuar dhe më e përdorur në treg. Pozita jonë si zgjedhja e parë e klientit na jep një përgjegjësi edhe më të madhe, për të qenë kudo ku klientët tanë janë dhe për t'i dëgjuar në mënyrë aktive nevojat e tyre.

Kompetenca e pa konkurrencë, ekspertiza, dëgjimi aktiv, dhe zbatimi i aftësive kanë dëshmuar edhe një herë të jenë çelësi për një vit të shkëlqyer për biznesin tonë të kartelave. Me kombinimin e nevojave të klientëve dhe zhvillimeve të reja teknologjike, ne kemi vazhduar të prezantojmë produkte të reja, shërbime të zgjeruara dhe kanale të reja të shfrytëzimit në mënyrë që klientët tanë të mund të kryejnë transaksione bankare siç atyre ju përshtatet, kudo që ata janë, pa kufizimet e imponuara nga orët tradicionale të ofrimit të shërbimeve bankare.

Ne kemi prezantuar Bankomatët për depozitim në mënyrë që klientët tanë të mund të depozitojnë në llogaritë e tyre duke përdorur rrjetin tonë të bankomatëve. Në vend se të presin në rend në një degë për të kryer pagesat e Starcard-ës, klientët tani mund të paguajnë faturat e tyre me kartelë në bankomate nga llogaritë e tyre rrjedhëse ose të bëjnë pagesat në para të gatshme drejtpërdrejt për të paguar kartelën e tyre ose kartelën e dikujt tjetër.

Një nga synimet tona është që të ndikojmë pozitivisht në jetën e klientëve tanë dhe në të njëjtën kohë ta mbrojmë mjedisin. Pra, në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ne kemi prezantuar një mënyrë të thjeshtë për financimin

e projekteve që do të përmirësojnë performancën e energjisë. Tarifat dhe ngarkesat janë të njëjta si për çdo blerje tjetër të mallrave dhe shërbimeve në një plan të pagesës me këste, por klienti merr edhe një stimul financiar, nëse këto pëmbushin kriteret 'e gjelbra'.

Meqë kemi kujdes në lidhje me mirëqenien (financiare) të klientëve tanë, ne duam të sigurohemi se ata janë në krye të shpenzimeve të tyre dhe mund t'i monitorojnë shpenzimet e tyre dhe borxhet për pagesë. Ne e bëjmë këtë duke mundësuar kanale të gjithanshme për t'iu qasur gjendjeve të tyre të kartelave të kredisë. Përveç gjendjeve mujore, qasjes përmes e-banking dhe përmes qendrës sonë të thirrjeve, ne kemi prezantuar edhe mundësinë e shtypjes së gjendjeve të tyre nëpërmjet rrjetit të bankomatëve.

Me një bazë në rritje të klientëve, nevojat për të garantuar gjithmonë shërbimet më të mira është prioriteti i lartë për TEB-in. Kështu, ne kemi zgjeruar ekipin tonë të shitjes direkte dhe aktivitetet. Ne jemi tani edhe më afër klientëve dhe të aftë për t'iu përgjigjur më shpejt dhe më besueshëm nevojave të tyre. Ekipi i shitjes direkte është gjithashtu në dispozicion për të ofruar informacion për oferta speciale për të cilat mund të ketë të drejtë klienti dhe për produktet dhe shërbimet e reja të vëna në dispozicion nga Banka dhe të cilat ne mendojmë që mund të jenë me interes dhe në dobi të klientit.

Gjatë gjithë vitit dhe në partneritet me tregtarët, Banka ka iniciuar fushata të shumta të personalizuara, duke ofruar propozime të ndryshme që paraqesin plane shtesë të pagesave, ulje, periudha të pritjes dhe produkte bonus. Ne jemi

+140

MBI 63% E GJENDJEVE TANI
DËRGOHEN PËRMES E-MAILIT.
KJO DO TË THOTË SE MBI 140
PEMË U SHPËTUAN NË VITIN
2014.

NË FUND TË VITIT 2014, BANKA JONË KISHTE LËSHUAR 82% TË TË GJITHA KARTELAVE AKTIVE TË KREDISË NË KOSOVË.

mirënjohës për besnikërinë e klientëve dhe për t'iu falënderuar klientëve ne përsëri kemi shpërndarë mbi 500,000 € në pikë bonusi në kartela ose si bonuse në forma të tjera. Përveç kësaj, që nga ky viti, kemi prezantuar edhe bonuse për pagesa me kartela të debisë.

Gjatë vitit 2014, ne kemi ofruar mundësi të pandërprerë të transaksionit përmes rrjetit tonë kombëtar prej 52 bankomatësh dhe 3500 terminaleve të POS-it, dhe nëpërmjet të gjithë bankomatëve, POS-ave ose rrjeteve të e-tregtisë në mbarë botën. Numri i transaksioneve përmes terminaleve të POS-it është rritur për 26% në krahasim me vitin e kaluar dhe gjithsej qarkullimi i POS-ave është rritur 25%. Ne krenohemi me faktin se klientët janë shumë të kënaqur me shërbimet tona. Kjo ka çuar në depërtim edhe më të madh të tregut dhe në fund të vitit 2014, banka jonë kishte lëshuar 82% të të gjitha kartelave aktive të kredisë në Kosovë.

Tarifat dhe komisionet tona që lidhen me mirëmbajtjen dhe përdorimin e kartelave janë shumë konkurruese në treg dhe ne gjithashtu ofrojmë një llojllojshmëri të transaksioneve pa pagesë, si pagesat online dhe blerjet ndërkombëtare me kartelë të kredisë.

Me teknologjinë gjithnjë e më të sofistikuar, mashtrimi me kartela në të gjithë botën është përhapur në një ritëm dinamik. TEB-i ka investuar shumë në siguri të avancuar për rrjetin tonë të infrastrukturës. Kjo menaxhohet nga ekipi ynë shumë vigjilent i monitorimit në kohë reale. Ne besojmë se siguria e transaksioneve është padyshim një nga sukseset tona, sepse transaksionet në tentativë mashtruese duke përdorur

kartelat tona dhe në rrjetin tonë mbeten konsiderueshëm nën tendencat e sektorit.

Në vitin 2014 dhe si pjesë e përgjegjësisë sonë sociale, ne kemi vazhduar të rekomandojmë fuqishëm opsionin e gjendjes elektronike për klientët. Kjo redukton përdorimin e letrës dhe mbi 63% e gjendjeve tani dërgohen në mënyrë elektronike përmes e-mailit. Kjo do të thotë se mbi 140 pemë u shpëtuan në vitin 2014.

Çka më tutje?

Në vitin 2015, ne kemi për qëllim të mbajmë pozitën tonë si udhëheqës i pakrahasueshëm në biznesin e kartelave. Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë rrjedhën tonë të inovacionit, angazhimit dhe partneritetit me klientët tanë, duke gjeneruar performancë financiare të fuqishme. Qëllimi ynë kryesor sigurisht do të mbetet zhvillimi dhe lehtësimi i mënyrave se si personat duan të bëjnë dhe të pranojnë pagesa, duke futur produkte dhe shërbime të reja dhe të zgjeruara për klientët tanë individualë dhe të biznesit.

Një risi e planifikuar për vitin 2015 dhe në shenjë vlerësimi të grave kliente, ne jemi në procesin e dizajnit të Kartelës 'She Card'. Kjo është një kartelë e kredisë revolvuese e licencuar nga Visa, e krijuar enkas dhe e mbushur me elemente shtesë të përshtatshme për gruan e ditëve të sotme. Ajo do të ofrojë ulje të dedikuara dhe oferta të tjera të veçanta përveç tipareve standarde të kartelës së kredisë.

Ne jemi duke punuar edhe në një "funktion me këste" për pagesat ndërkombëtare dhe e-tregtinë që do t'i shtohet të gjitha kartelave të kredisë në vitin 2015.

SHËRBIMET BANKARE PËR NVM-TË

TEB-i lehtëson operacionet për NVM-të, fermerët dhe agro-bizneset

TEB-i iu shërben klientëve të NVM-ve (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme), përmes një qasje të përshtatur dhe ofertave të shumta të produkteve. Në vitin 2014, ekipi ynë i NVM-ve ka ndërtuar vite përvojë në këtë segment të rëndësishëm ekonomik. Megjithatë, krahasuar me vitet e mëparshme, ekipi ka punuar në një mjedis shumë më të vështirë, sepse kemi parë rënie në shitje dhe në shkallën e arkëtimit. Për më tepër, bankat e tjera u përqendruan më shumë në këtë segment, duke e bërë konkurrencën edhe më intensive dhe duke nxitur luhatje në çmimet e kredisë. Kombinimi i këtyre faktorëve ka kontribuar në një numër më të lartë se sa ishte parashikuar të kredive jo performuese (KJP) dhe një prirje në rënie në çmimet e kredisë. Pavarësisht kësaj, ekipi i NVM-ve ka arritur të performojë mirë dhe vazhdoi rritjen dhe zgjerimin e tij në segment nëpërmjet inovacionit dhe marrëdhënieve të zgjeruara të klientëve.

Rritja e zakonshme, që është bërë si një markë tregtare për shërbimet bankare të NVM-ve të TEB-it, ka vazhduar në vitin 2014, me rritjen e portofolit me 12 milion € shtesë ose 12.3% në përqindje. Kjo rritje u arrit përmes një niveli të lartë të proaktivitetit në treg nga stafi i shitjes i Bankës dhe nëpërmjet organizimit të fushatave të përgjithshme dhe të segmentit të caktuar. Përpjekjet stafit të Bankës në pjesën e shitjes kanë gjeneruar biznes të ri me klientët ekzistues dhe ia kanë arritur për

të tërhequr klientë të rinj, një arritje e cila është shumë e rëndësishme për rritjen e ardhshme. Gjatë vitit 2014, 3,144 klientë kanë aplikuar dhe kanë marrë kredi me këste për herë të parë. Ky përbën 26.7 milionë € në limite të reja. Ky është një tregues i fortë i efikasitetit të Bankës në pjesën e shitjes dhe vlerës së brendit tonë në treg.

Ne kemi qenë në gjendje të arrijmë këtë rritje përmes qasjes tonë kryesore të ndërshitjes. Kjo është një qasje me klientin në qendër, që edhe një herë dëshmoi shumë efektive në ofrimin e shërbimeve të plota bankare për klientët dhe duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në gjenerimin e të hyrave jo nga interesi. Si rezultat i kësaj, të hyrat jo nga interesi u rritën me 19.8% gjatë vitit 2014 në krahasim me vitin 2013 ose, në terma realë, për 448,000 €. Përsëri, ky është një tregues i rëndësishëm pasi që tregon se edhe klientët ekzistues dhe ata të rinj i vlerësojnë shërbimet tona dhe janë të gatshëm të kryejnë shërbimet e tyre bankare me TEB-in.

Në aspektin e inovacionit, ekipi i NVM-ve ka qenë shumë aktiv në vitin 2014. Ne kemi shtuar një fokus të veçantë - "Ndërmarrësinë e grave" - që ka si objektivi gratë që tashmë merren me biznes dhe ato që aspirojnë të bëhen ndërmarrëse, të cilat përballen me kufizime financiare, kur bëhet fjalë për realizimin e ambicieve të tyre. Programi është projektuar posaçërisht për të fuqizuar një pjesëmarrje më të madhe të grave në biznes ndërsa përfshin

19.8%

TË HYRAT JO NGA INTERESI U RRIEN ME 19.8% GJATË VITIT 2014 NË KRAHASIM ME VITIN 2013.

NJË RISI E MËTEJSHME DHE E RËNDËSISHME ËSHTË PREZANTUAR PËR KLIENTËT E SEGMENTIT AGRO TË BANKËS: KARTELA AGRO.

elemente financiare dhe jo-financiare, si trajnime dhe konsulencë. Siç qëndrojnë punët tani për tani, nënshkrimi i një marrëveshje të bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim është vetëm çështje e kohës, marrëveshje e cila do të rrisë më tej programin dhe ofertën e Bankës në këtë segment të tregut. Duke miratuar këtë qasje të zhvillimit të biznesit, Banka beson se ne do të nxisim shfaqjen e ideve të reja të biznesit në treg, si dhe do të krijojmë një segment të ri të suksesshëm për të ardhmen.

Një risi e mëtejshme dhe e rëndësishme është prezantuar për klientët e segmentit Agro të Bankës: Kartela Agro. Lansimi i Kartelës Agro është një ngjarje të rëndësishme sepse është kartela e parë e kredisë e prezantuar në mënyrë specifike për këtë segment të tregut dhe karakteristikat e saj janë të përshtatura për specifikat e këtij biznesi të veçantë. Për shkak të karakteristikave të saj të përshtatura, Kartela Agro ka dëshmuar të jetë një sukses i menjëhershëm në treg dhe 1,000 kartelat e para janë lëshuar brenda tre muajve pas lansimit. Paralelisht, me kartelë Banka ka forcuar më tej praninë e saj në agrobiznes dhe e ka bërë të qartë se TEB-i synon të bëhet lider i tregut në këtë segment të veçantë.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në lidhje me aktivitetet tona të NVM-ve ishte organizimi i një ngjarje të adaptuar të "Akademiës së Biznesit". Kompani nga të dy segmentet, mikro dhe bizneset e vogla, ishin të ftuara për një ditë me seminare të

organizuar në tema të tilla si strategjitë e rritjes dhe menaxhimi i ndryshimeve. Ngjarja u përqendrua në praktikat më të mira dhe njohuritë e menaxhimit me synim optimizimin e vendimmarrjes për pronarët e bizneseve. "Akademia jonë e Biznesit" shënon një qasje të re në marrëdhëniet tona me këta klientë dhe Banka do të përpiqet të ofrojë trajnime dhe konsulencë në baza të rregullta, që do t'i pajisë klientët me ekspertiza të nevojshme për të qenë më konkurrues.

Çka më tutje?

Pas një viti me ngjarje të rëndësishme dhe momente të shënuara, ekipi i NVM-ve ka për qëllim të vazhdojë me këtë vrull në vitin 2015. Edhe pse ne parashikojmë një vit sfidues dhe konkurrencë të intensifikuar, ne jemi të bindur në aftësitë tona për t'u përshtatur nëpërmjet inovacionit dhe shërbimit cilësor të klientëve. Segmenti i NVM-ve ka një rëndësi të veçantë për TEB-in, sepse ne konsiderojmë se ka potencialin më të lartë për risi dhe krijimin e punësimit shumë të nevojshëm. Kjo është arsyeja që ne vazhdojmë së punuari pa u lodhur për t'i mbështetur kompanitë e NVM-ve me zgjidhje financiare dhe jo-financiare për të ndihmuar zhbllokimin dhe avancuar potencialin e tyre.

SHËRBIMET BANKARE KOMERCIALE DHE PËR KORPORATA

STRATEGJIA BANKARE E KORPORATAVE E TEB-it ËSHTË E STRUKTURUAR RRETH NDËRTIMIT TË BASHKËPUNIMIT AFATGJATË DHE THELLIMIT TË MARRËDHËNIEVE TONA AKTUALE ME KLIENTËT.

Strategjia bankare e korporatave e TEB-it është e strukturuar rreth ndërtimit të bashkëpunimit afatgjatë dhe thellimit të marrëdhënieve tona aktuale me klientët

Çfarëdo qoftë biznesi juaj, marrëdhëniet e ngushta me klientët janë të rëndësishme. Për ekipet tona të shërbimeve bankare komerciale dhe të korporatave, ato janë jetike. Kjo është arsyeja pse ne kemi përkrahur plotësisht dhe kemi integruar qasjen tonë me klientin në qendër në të gjitha aktivitetet tona bankare korporative, gjersa përpiqemi që të ofrojmë shërbimet më të mira bankare në dispozicion për këtë segment të rëndësishëm. Kjo përkthehet në ofrimin e shërbimeve të sofistikuar duke përdorur teknologjinë më të fundit dhe komunikim të afërt nëpërmjet zyrtarëve të dedikuar të portofolit.

Çdo shqyrtim i performancës së ekipeve tona komerciale dhe të korporatave në vitin 2014 duhet të ofrojë kontekstin, veçanërisht për zhvillimet politike në vend. Pas një gjysmë viti të parë të fuqishëm,

me kredi të papaguara që arritën në 77.2 milion €, dhe parashikimeve për gjysmën e dytë që premtinin ngjashëm, kosovarët shkuan në votime në qershor të vitit 2014. Pas zgjedhjeve, partitë politike nuk ishin në gjendje për të arritur konsensus për një qeveri të re dhe vendi hyri në një periudhë krize. Kjo situatë e pashembullt zgjati deri në fillim të dhjetorit. Efektet e saj në ekonomi ishin të konsiderueshme, sidomos në mesin e korporatave kryesore. Investimet u vunë në pritje deri sa situata u stabilizua. Viti në fund përfundoi me një notë pozitive dhe ekipi ynë i korporatave ishte në gjendje për ta mbyllur vitin me 2.6 milion € në kredi të reja.

Pavarësisht performancës së dobët në drejtim të rritjes së kredisë, ekipet Komerciale dhe të Korporatave vazhduan të ofrojnë shërbime që kërkohen dhe vlerësohen nga tregu. Në këtë drejtim, kemi arritur një rritje në të hyrat jo nga interesi prej 8.1%, duke e përfunduar vitin me 2.7 milion € në Të hyra.

77.2 milion €

PAS NJË GJYSMË VITI TË PARË TË FUQISHËM, ME KREDI TË PAPAGUARA QË ARRITËN NË 77.2 MILION €.

Akademia e Biznesit

NJË PORPOZIM ME VLERË TË VEÇANTË, NJË "AKADEMI E BIZNESIT" E DEDIKUAR U KRIJUA PËR KLIENTËT TANË TË KORPORATAVE.

Banka është shumë e vetëdijshme për rëndësinë e sistemeve të pagesave për klientët e korporatave dhe menaxhimin e parave të gatshme dhe zgjidhjet e marketingut janë qendrore në strategjinë dhe zhvillimin tonë në të ardhmen.

Transaksionet efikase të pagesave dhe gama e zgjidhjeve të biznesit dokumentar e mbështetur nga gama jonë e plotë e kartelave dhe POS-ave i kanë mundësuar klientëve tanë Komercial dhe të Korporatave për të kryer biznes me Bankën shpejt dhe me efikasitet.

Në përpjekjet tona për ta dalluar TEB-in nga konkurrenca dhe për të ofruar një propozim me vlerë të veçantë, një "Akademi e Biznesit" e dedikuar u krijua për klientët tanë të korporatave. Është qartë, njëri nga qëllimet është forcimi i marrëdhëniet tona të biznesit me këtë segment të rëndësishëm. Por ne gjithashtu duam të ndajmë njohuritë. Kështu që, kjo ngjarje ngriti tema të tilla si trendet globale të biznesit, menaxhimi i rritjes dhe ndryshimeve. Kjo ngjarje shënon fillimin e integritit të shërbimeve jo-financiare në fushëveprimin tonë dhe në të ardhmen ato do të luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve të tregut.

Çka më tutje?

Duke shikuar përpara për vitin 2015, ne kemi marrë në konsideratë mundësinë e luhatjeve afatshkurtra për shkak të situatës politike të pashembullt në vitin raportues. Megjithatë, ne mbetemi të bindur se qasja dhe filozofia jonë e biznesit do të vazhdojë në rrugën e duhur për sa i përket rezultateve. Duke pasur parasysh këtë, ne konsiderojmë se kjo është koha e duhur për të ndarë Departamentin tonë Komercial dhe të Korporatave në njësi të dedikuara. Ky ndryshim do të kontribuojë për një qasje më dinamike ndaj shërbimit të klientit. Në të njëjtën kohë, ne kemi për qëllim të fillojmë me zbatimin e sinergjisë më intensive midis departamenteve të shitjes dhe ne besojmë se ekipet Komerciale dhe të Korporatave duhet të jetë në ballë të kësaj strategjie të shitjes. Si Bankë, ne jemi të bindur se këto zhvillime strategjike në kombinim me standardin tonë ekzistues të shërbimit do të mundësojë një kthim në rritje të kredisë në vitin e ardhshëm.

FINANCAT TREGTARE

TEB Sh.A e kupton se biznesi ndërkombëtar në një botë të globalizuar është një sfidë - suksesi kërkon njohuri të gjera profesionale dhe një rrjet efektiv. TEB-i i ka të dyja.

Në vitin 2014, ne kemi vazhduar të përkrahim klientët tanë, duke krijuar dhe përshtatur zgjidhje të financave tregtare për nevojat e tyre të biznesit. Për më tepër, ne kemi punuar vazhdimisht në zgjerimin e rrjeteve tona, forcimin e marrëdhënieve me bankat e tjera, dhe ngritjen e mëtejme të standardeve tona të larta të profesionalizmit dhe kompetencës. Përkrahur nga prania globale dhe ekspertiza në tregtinë ndërkombëtare e BNP Paribas dhe TEB A.Ş., ne vazhdimisht zgjerojmë mbulimin tonë gjeografik dhe gamën e produkteve tona.

Produktet e financave tregtare për operacionet e biznesit dokumentar përfshijnë letër kreditë e importit dhe eksportit, skontimin në letër kredi, garancitë vendore dhe ndërkombëtare, letër kreditë në pritje (stand-by) dhe arkëtimet. Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2011 me programin e tregtisë së Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC-së) na ka dhënë një mundësi të shkëlqyer dhe më shumë fleksibilitet për t'iu përgjigjur kërkesës në lidhje me letër kreditë e konfirmuara dhe kundër garancitë. Gjatë vitit raportues, ne gjithashtu kemi zgjeruar më tej

marrëdhëniet tona me banka të reja korrespondente.

Ashtu si gjithë personeli i TEB-it, ekipi ynë i financave tregtare është i angazhuar në arsim të përhershëm, duke përfshirë programet e mësimi elektronik (e-learning) të krijuara nga BERZH-i dhe Oda Ndërkombëtare Tregtare (ONT). Qëllimi i këtyre programeve është që të arrijnë praktikat më të mira ndërkombëtare në financat tregtare edhe duke i kuptuar plotësisht rregullat tregtare të ONT-së.

Çka më tutje?

Në vitin e ardhshëm, ne do të vazhdojmë të mbështesim klientët tanë, duke siguruar një urë të sigurt për mundësi të reja. Profesionalizmi dhe ekspertiza do të jenë udhëzuesit tanë, sepse ne i shohim këto si diferencues në një botë që lëviz me shpejtësi. Ne gjithashtu jemi duke synuar që gamës së produkteve tona t'i shtojmë produkte të reja tregtare ndërkombëtare në vitin 2015.

Profesionalizmi dhe ekspertiza

PROFESIONALIZMI DHE EKSPERTIZA DO TË JENË UDHËZUESIT TANË, SEPSE NE I SHOHIM KËTO SI DIFERENCUES NË NJË BOTË QË LËVIZ ME SHPEJTËSI.

MENAXHIMI I PARASË DHE SISTEMET E PAGESAVE

SDD-ja

TEB-i E PARA E KA PREZANTUAR SISTEMIN E DEBITIMIT DIREKT (SDD). SDD-ja ËSHTË NJË PRODUKT UNIK NË TREGUN E KOSOVËS QË ËSHTË PROJEKTUAR PËR TË PËRKRAHUR BASHKËPUNIMIN KOMERCIAL B2B.

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë. Kjo është arsyeja pse ne jemi duke investuar shumë në kanalet alternative të shpërndarjes duke zhvilluar dhe përmirësuar platformën tonë të shërbimeve bankare elektronike e-banking

Në një kohë të progresit të shpejtë teknologjik, TEB-i është duke bërë më shumë se duke mbajtur ritmin dhe duke parashikuar progres në menaxhimin e parasë së gatshme dhe sistemet e pagesave gjersa vazhdon të shtojë kanale të reja të pagesave dhe mundësi për shërbime më të mira. Menaxhimi ynë i parave të gatshme dhe zgjidhjet për pagesa janë përshtatur për t'i ofruar klientëve tanë afaristë një gamë të produkteve dhe shërbimeve që do ta rrisë likuiditetin. Ne sigurojmë infrastrukturën e duhur për përpunim të shpejtë dhe të sigurt të pagesave. Për më tepër, duke shfrytëzuar zgjidhjet tona të teknologjisë së fundit klientët tanë krijojnë kursime të kostos dhe përfitojnë nga optimizimi i shpenzimeve operative direkte dhe indirekte.

TEB-i e para ka prezantuar sistemin e debitimit direkt (SDD). SDD-ja është një produkt unik në tregun e Kosovës që është e projektuar për të përkrahur bashkëpunimin komercial B2B (biznes me biznes). Funkzioni i saj kryesor është për të përmirësuar likuiditetin financiar të klientëve tanë të biznesit duke ofruar menaxhimin e plotë të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme. Ai konsiderohet si sistemi më efektiv i menaxhimit të rrjedhës së parasë pasi përkrahet nga teknologjia e fundit dhe ndërlihdhet ndërmjet sistemeve për të lehtësuar procedimin e plotë dhe

automatik të pagesës së faturave. Kjo i mundëson klientëve që të na autorizojnë për të debituar (tërhequr) automatikisht mjete direkt nga llogaria e tyre bankare për të bërë pagesa të ndryshme mujore për kompani të ndryshme publike dhe private. Nevojitet vetëm një formular i autorizimit (i nënshkruar nga klienti) dhe transaksioni përkatës do të kryhet automatikisht. Klientët me SDD marrin linjë kreditore të dedikuara që mundëson pagesat për furnizuesit dhe garanton se kushtet e pagesës së faturës respektohen plotësisht. Hapi tjetër logjik ishte futja e skontimit të SDD-së që garanton të arkëtueshmet. Duke zbatuar skontimin e SDD-së, klienti konsolidon financat dhe përfiton nga arkëtimi i hershëm i të arkëtueshmeve. Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë. Kjo është arsyeja pse ne jemi duke investuar shumë në kanalet alternative të shpërndarjes duke zhvilluar dhe përmirësuar platformën tonë të shërbimeve bankare elektronike e-banking. Shërbimi ynë ultra-modern online shfrytëzon sistemet më të avancuara të sigurisë dhe jep qasje në shërbimet bankare të sigurta, të përshtatshme dhe të shpejta 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Klientët tanë mund të transferojnë fondet në mënyrë elektronike te përfituesit në mbarë botën dhe të procedojnë pagesa vendore, duke përfshirë pagesën e shërbimeve komunale dhe debi të tjera të rregullta, (si rryma, uji dhe telefoni). Për më tepër, klientët mund të zgjedhin edhe për të bërë pagesat për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) automatikisht duke përdorur e-banking.

Sot, transferet e shpejta dhe të sigurta ndërkombëtare të parave janë me rëndësi të madhe për klientët me ambicie që tejkalojnë kufijtë. Kjo është arsyeja pse ne

MENAXHIMI I PARASË DHE SISTEMET E PAGESAVE

ofrojmë një shërbim që është mënyra më e lehtë, më e shpejtë dhe më e besueshme për të bërë pagesa ndërkombëtare. Nëpërmjet rrjetit tonë të gjerë të mbi 150 marrëdhënieve korrespondente të huaja dhe 30 bankave për plasim, pagesat ndërkombëtare dalëse mund të kryhen për përfituesit e huaj në të gjithë botën. Si anëtar i SWIFT-it, rrjetit më të madh në botë të pagesave, klientët tanë gëzojnë një përparësi të qartë, sidomos në pagesat ndërkombëtare dalëse. Pagesat ndërkombëtare hyrëse mund të menaxhohen duke përdorur të njëjtin sistem. Kjo do të thotë që ne jemi në gjendje të ofrojmë shërbime të pagesave që janë udhëheqëse në treg, gjithashtu nëpërmjet aktiviteteve të brendshme shumë efektive dhe përmes zgjerimit të vazhdueshëm të rrjetit tonë global.

Në vitin 2014, ne përsëri kemi marrë një çmim për cilësinë e lartë të Pagesave tona ndërkombëtare dalëse nga Deutsche Bank AG Gjermani. Ne kemi arritur normë të jashtëzakonshme prej 100% STP. Çmimi i njëjtit transaksionet në vitin 2013.

Në vitin 2014, ne filluam me zbatimin e IBAN-it, duke e përfunduar procesin dhe duke dalë me të në shkurt të vitit 2015 IBAN - Numri i ndërkombëtar i llogarisë bankare - është një format i standardizuar ndërkombëtar për numrat e llogarive bankare, që është themeluar në pajtim me standardet ndërkombëtare të pagesave. Ai përdoret në nivel ndërkombëtar për të identifikuar llogarinë e klientit në një institucion të veçantë financiar dhe për të bërë pagesa jashtë vendit. IBAN-i përshpejton përpunimin e pagesave ndërkombëtare dhe redukton vonesat

në këto procese. IBAN-i në Kosovë do të përbëhet nga 20 karaktere alfanumerike. Duke e përdorur këtë sistem, ne - dhe klientët tanë - do të jemi në gjendje për të përmirësuar ndjeshëm cilësinë e pagesave STP, veçanërisht transaksionet hyrëse.

Rritja e biznesit tonë dhe shpejtësia e zhvillimeve në menaxhimin e parasë së gatshme na çoi në krijimin e Njësisë së dytë të Bartjes së parasë së gatshme, në vitin 2014. Fillimisht, ne kemi punuar me një të tillë. Tani, ne besojmë se gama e shërbimeve për të cilat kanë nevojë klientët tanë justifikon një ekip më të madh. Në vitin 2014, kemi nisur një shërbim të ri ku ne arkëtojmë dhe dërgojmë paratë e gatshme nga dhe në objektet e klientit. Ne kemi përvojë të konsiderueshme në organizimin e arkëtimeve të tilla - ekipi tashmë kujdeset për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë bankomatëve jashtë pikave të bankës në dhe rreth Prishtinës. Gjatë vitit 2014, ne kemi menaxhuar 1.292 raste problematike me sukses pa i bezdisur klientët.

Çka më tutje?

Ne mbesim të përkushtuar për të përmirësuar më tej përvojën e klientëve duke ofruar zgjidhje superiore të menaxhimit të parasë së gatshme dhe zgjidhje të pagesave të bazuara në infrastrukturën tonë të avancuar teknologjike. Pra, ne do të përqendrohemi në zhvillimin dhe përmirësimin e kanaleve alternative të shpërndarjes si platforma për zgjidhje dhe shërbime fleksibile që do ta lehtësojnë punën për klientët tanë.

RRITJA E BIZNESIT TONË DHE SHPEJTËSIA E ZHVILLIMEVE NË MENAXHIMIN E PARASË SË GATSHME NA ÇOI NË KRIJIMIN E NJËSISË SË DYTË TË BARTJES SË PARASË SË GATSHME NË VITIN 2014.

THESARI

Menaxhimi i matur i asetëve dhe detyrimeve është thelbësor për shërbime financiare të qëndrueshme dhe të sigurt për klientët tanë

Në TEB, ne e dimë shumë mirë rëndësinë e një Departamenti të fortë, me përvojë dhe shërbim të plotë të Thesarit. Qëllimi ynë kryesor në thesar është maksimizimi i kthimeve të përshtatura me rrezikun në afat të gjatë. Brenda thesarit, ne krijojmë strategji të investimit dhe financimit bazuar në kushtet e tregut. Nëpunësit e thesarit janë gjithashtu përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit të Bankës, rrezikut operacional dhe strukturor të likuiditetit, rrezikut të këmbimeve valutore dhe rreziqeve të normës së interesit në bilancin e gjendjes. Si pjesë e menaxhimit të likuiditetit, banka ka përcaktuar treguesit kryesorë të rrezikut të likuiditetit dhe i monitoron në vazhdimësi ata.

Për më tepër, në aspektin e menaxhimit të rrezikut, nëpunësit tanë të thesarit menaxhojnë asetet dhe detyrimet duke analizuar vazhdimisht rreziqet e mundshme dhe mundësitë e tregut në kuadër të rregullave të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i asetëve dhe detyrimeve (KAD).

Ekipet tona të Thesarit dhe MAD-së luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e besimit dhe na mundësojnë që të qëndrojmë të fortë, madje edhe në kohë sfiduese. Përvoja e kombinuar, njohuritë teorike dhe teknike, gama e gjerë e produkteve, dhe zgjidhjet e përshtatura inovative janë pikat e tyre të forta. Për më tepër, performanca e

suksesshme e Thesarit gjithashtu vjen për shkak të infrastrukturës sonë të avancuar teknologjike dhe bazës së të dhënave.

Edhe një herë, ky reputacion ka bërë që TEB-i të zgjedhet si akteri primar për emetimin e bonove të thesarit të Qeverisë me afat dy-vjeçar. Si rezultat, Ministria e Financave ishte në gjendje që të rris borxhin e përgjithshëm në 259.52 milion €.

Menaxhimi i rrezikut

Ne jemi shumë të vetëdijshëm për rreziqet e mundshme dhe vazhdimisht monitorojmë dhe menaxhojmë rrezikun e likuiditetit, të palëve tjera, valutës së huaj, portfolios së të ardhurave fikse dhe normës së interesit që mund të shfaqen nga aktivitetet tona rutinore. TEB Sh.A punon ngushtë me TEB A.Ş., duke përfitur nga parashikimet e sakta të tregut, veçanërisht për menaxhimin e normave të interesit dhe hendekut të likuiditetit. Kontrolli i brendshëm i rreptë është çelësi për të gjitha aktivitetet tona të thesarit. Ne kemi zhvilluar dhe vendosur praktika të kujdesshme që zvogëlojnë dhe zbusin rrezikun në aktivitetet tona të menaxhimit të asetëve dhe detyrimeve.

Çka më tutje?

Duke shikuar përpara për vitin 2015, pritjet që Ministria e Financave të prezantojë Obligacionet me maturitet më të gjatë (nga tre deri në pesë vite). TEB-i synon të marrë pjesë si Akter Primar në këto ankande.

BURIMET NJERËZORE

E gjitha ka të bëjë me njerëzit

Roli i ekipit të burimeve njerëzore të TEB-it është të tërheqë, mbajë dhe motivojë njerëzit më të mirë gjatë kohës që i mundëson tërë organizatës për t'u adaptuar dhe përshtatur vazhdimisht në një mjedis ekonomik që ndryshon me shpejtësi. Kjo është një detyrë sfiduese sepse ne jemi në kërkim të talenteve më të mirë të rinj dhe dinamik në tregje, energjia dhe angazhimi i të cilëve ndaj shërbimit të klientëve përshtatet me kulturën tonë të biznesit. I gjithë stafi ynë kontribuon në rritjen e vazhdueshme të Bankës. Ndaj dhe duan më të mirën. Kjo është arsyeja pse ne ofrojmë një paketë konkurruese të përfitimeve, duke përfshirë sigurimin shëndetësor dhe mundësi të karrierës. Duke pasur parasysh këtë, ne kemi zhvilluar një politikë të burimeve njerëzore të bazuar në lëvizshmëri të brendshme dhe zhvillimin aktiv të aftësive të stafit tonë gjersa promovojmë dhe nxisim diversitetin brenda bankës.

Në fund të vitit 2014, ekipi i plotë i TEB-it ishte rritur në 598 të punësuar. Kjo është një rritje prej 136 profesionistësh të shërbimeve bankare dhe financiare. Në aspektin e lëvizshmërisë, 103 punonjës të TEB-it janë promovuar ose iu janë dhënë sfida të reja gjatë vitit 2014. Afër 20 më shumë ishin në gjendje të pranojnë sfida të reja në lokacione të tjera.

Komunikimi i hapur

Që kur TEB-i hapi dyert e saj në vitin 2008, ne kemi ndjekur një politikë të dyerve të hapura të dizajnuar për të krijuar një mjedis të rehatshëm të punës. Punonjësit

janë të inkurajuar për të folur sinqerisht me menaxherët e tyre. Mbahen takime të rregullta për të komunikuar për misionin, vizionin, strategjitë dhe objektivat e Bankës, dhe për të afirmuar rëndësinë e stafit tonë për arritjen e qëllimeve tona. Kjo rëndësi është shprehur edhe në mënyrën se si ne investojmë në trajnime dhe zhvillim.

Trajnimi dhe arsimimi

Në përputhje me vizionin tonë "që të jemi banka më e mirë në Kosovë", ne kemi krijuar një numër të programeve të trajnimit të dedikuara për grupe të ndryshme brenda organizatës. Të gjitha trajnimet janë ofruar nga ekspertë të huaj, të njohur dhe shumë të respektuar të trajnimit. Menaxherët tanë të lartë marrin pjesë në Programin e Liderimit Strategjik Ekzekutiv, duke marrë trajnime individuale dhe duke punuar me kolegët përmes lojës në role dhe studimeve interaktive në grup. Çdo ekzekutiv ka gjithashtu plane të zhvillimit individual. Menaxhmenti i mesëm e ka programin e vet të dedikuar, që synon përmirësimin e kompetencave menaxheriale dhe aftësive të udhëheqjes. Ky Program i menaxhimit dhe zhvillimit të udhëheqjes përfshinë punën në klasë, intervista, seanca individuale të trajnimit, prezantime dhe "detyra të shtëpisë". Fokusi është në menaxhimin strategjik, menaxhimin e stafit, përsosmërinë operative dhe menaxhimin e kohës. Menaxherët tanë më të rinj dhe më me pak përvojë ndjekin Programin e zhvillimit të menaxherëve, duke u fokusuar në menaxhimin efektiv të stafit, udhëheqjen e situatës, trajnim, menaxhim të performancës së delegimit dhe reagim.

598

NË FUND TË VITIT 2014, EKIPI I PLOTË I TEB-it ISHTE RRI TUR NË 598 TË PUNËSUAR.

NË VITIN 2014, GJITHSEJ 85 KURSE TË NDRYSHME JANË ORGANIZUAR PËR TË TRAJNUAR 687 PUNONJËS NË BANKË DHE 563 PUNONJËS MORËN PJESË NË KURSE TË JASHTME.

Edhe Programi i zhvillimit të menaxherëve përfshin vëzhgime personale të punës në klasë, raste studimore dhe “detyra të shtëpisë”.

Në vitin 2014, u organizuan programe të vazhdueshme të trajnimit, si brenda bankës ashtu edhe jashtë saj. Gjithsej, 85 kurse të ndryshme janë organizuar për të trajnuar 687 punonjës (dhe praktikantë) në bankë dhe 563 punonjës (dhe praktikantë) morën pjesë në kurse të jashtme. Për të siguruar zhvillimin e stafit tonë në përputhje me ndryshimet globale në ekonomi dhe teknologji, shumë nga stafi ynë kanë udhëtuar jashtë vendit për kurse në vende të ndryshme evropiane, duke përfshirë Turqinë, Republikën Çeke, Luksemburgun, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Francën, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Menaxhimi i lëvizshmërisë

Lëvizshmëria e brendshme është një komponent kyç i strategjisë së Burimeve Njerëzore të TEB-it. Përveç se e ndihmojmë stafin tonë të zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre, ne synojmë t’iu japim atyre mundësi për avancimin më tej të karrierës së tyre. Në vitin 2014, ne kemi nisur një Program të Qendrës së Vlerësimit dhe Qendrës së Zhvillimit (Programi QV/QZh) të dizajnuar në mënyrë specifike, për të krijuar një grup të menaxherëve me potencial të lartë dhe me performancë të mirë me mundësinë për t’u avancuar në organizatë. 17 pjesëmarrës u vlerësuan nga Qendra e Vlerësimit dhe më vonë iu bashkuan Qendrës së Zhvillimit. Ky program është hartuar dhe është ofruar në bashkëpunim me Akademinë e TEB-it në

Stamboll, Turqi. Gjatë vitit 2014, ‘studentët’ tanë të parë janë pranuar në Kampusin e BNP Paribas në Paris, Francë. Ky është një institucion prestigjioz i trajnimeve që përfiton nga ekspertiza globale e BNPP-së. Nëpërmjet pjesëmarrjes në Kampus, stafi ynë jo vetëm që do të përfitojë nga trajnime të nivelit të lartë, por gjithashtu do ta lehtësojë bashkëveprimin midis TEB-it dhe kompanisë tonë amë. Gjatë vitit raportues ne vazhduam bashkëpunimin tonë me Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe atë të Turqisë. Ky bashkëpunim mbështet nevojat tona të trajnimit teknik dhe rrit ndërgjegjësimin për zhvillimin, ndryshimet dhe sfidat në sektorin bankar në Kosovë dhe në mbarë botën.

Çka më tutje?

Në vitin 2015, ekipi i Burimeve Njerëzore do të vazhdojë të punojë për rekrutimin e talenteve më të mirë. Ambiciet tona të trajnimit do të mbeten po aq të larta si në vitin 2014, gjersa ne ndjekim më tej dhe krijojmë mundësi në mënyrë që stafi ynë të mund të përqendrohet në aftësitë e tyre praktike për t’i pajisur ata për lëvizshmëri të brendshme.

Duke jetuar vlerat dhe etikën tonë, ne e pranojmë se punonjësit tanë janë themeli mbi të cilin ne ndërtojmë Bankën që ne duam, një vend ku njerëz të talentuar dhe dinamik dëshirojnë të punojnë në një mjedis ku kolegët tanë dëshirojnë të zhvillojnë karrierën e tyre dhe të kontribuojnë në objektivat e përbashkëta të TEB-it.

ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I PROCESIVE

Bota dhe dinamika e saj po ndryshojnë vazhdimisht dhe po ashtu edhe klientët tanë dhe ambicjet dhe aspiratat e tyre. Në TEB, ne e shohim rolin tonë më shumë se thjesht një vëzhgues apo pasues në një botë dinamike. Ne jemi në qendër të asaj bote, siç dëshmojnë edhe përpjekjet tona për të përballuar sfidat e një mjedisi që ndryshon me shpejtësi. TEB-i ka qenë në ballë përmes gjërave "të para" të shumta dhe produkteve dhe shërbimeve të reja për të ndihmuar klientët tanë për të menaxhuar dhe përfituar nga ndryshimet. Ne e bëjmë këtë përmes modeleve të zgjuara dhe dinamike të biznesit që krijojnë një strukturë organizative që është e përshtatshme për qëllimin dhe mjaft fleksibile për të parashikuar ndryshimin dhe për të siguruar ndërrimet në nevojat e konsumatorëve. Për shembull, ne kemi përmirësuar dukshëm efikasitetin tonë të procesit në mënyrë që në një botë që varet nga përgjigjet e shpejta, transaksionet e klientëve tanë të jenë më të shpejta dhe më efikase.

Me një vizion për të qëndruar gjithmonë në një pozicion pionier me produkte dhe shërbime të reja, TEB Sh.A. vazhdon të dallohet dhe të bëjë ndryshimin në përvojën e klientit edhe me modele të zgjuara dhe dinamike të biznesit.

Modelet e zgjuara dhe dinamike të biznesit

Në një tjetër vit dinamik dhe produktiv, banka ka kryer me sukses veprimet dhe projektet që synojnë hartimin e strukturës së nevojshme organizative, duke zhvilluar infrastrukturën e saj të procesit dhe rritur efikasitetin në të gjitha aktivitetet e saj biznesore dhe operative.

Duke u bazuar në vlerat e saj thelbësore, banka ka vazhduar të adoptojë strukturën e vet organizative për të mbështetur pasionin e saj të pafund për ta përmirësuar veten. Struktura organizative e ridizajnuar shërben si një gur-themel për të rritur më tej efikasitetin organizativ dhe strategjinë e rritjes.

Me zhvillimet e infrastrukturës së procesit, banka është duke përkrahur metodat e reja të udhëheqjes së biznesit me qëllim që t'i prezantojë klientët me një mjedis të shpejtë, të lehtë dhe efektiv bankar, të projektuar rreth nevojave të tyre në funksion të dinamikës së ardhshme dhe trendeve të parashikuara të sektorit.

Duke hapur rrugën për ndryshime dhe ndërtimin për të ardhmen, proceset e biznesit analizohen në mënyrë të vazhdueshme për të identifikuar çdo mbingarkesë, pabarazi, kosto, dhe detyrë që nuk shton vlerë. Një rëndësi e madhe i është dhënë rritjes së efikasitetit të procesit, i cili do të shkurtojë kohën e transaksionit dhe t'i përshtatet me shpejtësi nevojave të klientëve.

Të kuptuarit dhe planifikimi për të ardhmen

Ne si vizionarë besojmë që mund ta bëjmë më të lehtë jetën e klientëve tanë dhe të jemi baza për përpjekjen e tyre të pafund për progres dhe aspiratën për të ndërtuar një të ardhme të ndritshme për veten e tyre dhe për shoqërinë. Si të tillë, në vitin e ardhshëm, ne do të vazhdojmë në mënyrë proaktive të dëgjojmë për të kuptuar edhe më mirë, për të menduar përpara, të bëhemi më mbështetës, dhe të optimizojmë modelin e biznesit tonë.

TEB Sh.A VAZHDON TË DALLOHET DHE TË BËJË NDRYSHIMIN NË PËRVOJËN E KLIENTIT EDHE ME MODELE TË ZGJUARA DHE DINAMIKE TË BIZNESIT.

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Përmirësimet teknologjike dhe përmirësimet në siguri

Gjatë vitit 2014, si banka udhëheqëse e teknologjisë në Kosovë, ne kemi kaluar sistemet tona kritike në harduer më të fuqishëm dhe më të sigurt. Përveç këtij projekti gjithëpërfshirës të migrimit, sistemet tona, kapaciteti dhe rikuperimi nga fatkeqësia janë përmirësuar. Kjo siguron shërbime më afatgjate, të shpejta dhe më të besueshme, të pandërprera për klientët tanë.

Siguria është një nga karakteristikat kryesore të çdo sistemi të informacionit. Kjo është arsyeja pse ne sistematikisht rrisim sigurinë e sistemeve tona duke prezantuar përparimet më të fundit dhe miratimin e zgjidhjeve më të mira në atë kategori në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë.

Një vit i inovacionit

Në vitin 2014, ne kemi vazhduar prezantimin e shërbimeve të reja për klientët tanë. Tani, mbajtësit e kartelave tona fitojnë shpërblime për pagesat me kartelë të debisë, të bëra duke përdorur терминаlet e POS-ave të TEB-it. Këta klientë mund të përfitojnë edhe nga funksioni i ri për depozitimin e parave të gatshme të mundësuar në bankomatët tanë. Kjo u mundëson atyre që të bëjnë depozita direkt në llogaritë e tyre duke përdorur bankomatin - kështu që nuk ka më qëndrime në radhë në degë. Bankomatët e TEB-it po ashtu ofrojnë mundësinë e balancimit të llogarisë së kartelës së kredisë me depozita në para të gatshme. Ne gjithashtu kemi zbatuar një funksion të ri për mbajtësit e kartelës së debisë që u mundëson atyre të tërheqin paratë e gatshme shpejt duke përdorur shërbimin e 'Fondeve të shpejta'.

SIGURIA E INFORMACIONIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Sigurimi i informacionit

Sot, të gjitha aktivitetet afariste janë gjithnjë e më të varura nga disponueshmëria e informacionit dhe siguria e sistemeve të informacionit për të ruajtur dhe proceduar të dhënat e ndjeshme dhe të vlefshme. Kjo është arsyeja pse mbrojtja e duhur dhe saktësia e informacionit në pronësi të Bankës apo që i është besuar asaj në rrjedhën normale të punës sonë është një parakusht dhe një përparësi e madhe për TEB-in. Banka ka zbatuar një program të fuqishëm dhe vazhdimisht në zhvillim të sigurisë së informacionit për ta mbajtur ritmin me kërcënimet në zhvillim. Banka vazhdon të monitorojë në mënyrë aktive rreziqet, kërcënimet e jashtme, monitorimin e brendshëm, shqyrtimin e praktikave më të mira dhe zbatimin e kontrolleve shtesë sipas nevojës, për të lehtësuar rreziqet e sigurisë. Gjatë vitit 2014, janë zbatuar disa projekte për të siguruar disponueshmërinë, elasticitetin dhe aftësinë për të kthyer të dhënat me ndërprerje minimale në aktivitetet e biznesit.

Programet e trajnimit të Bankës përfshijnë trajnim të detyrueshëm për sigurinë e informacionit dhe njoftimet të cilat sigurojnë që punonjësit të jenë të vetëdijshëm dhe të pajisur për të mbrojtur klientët tanë dhe asetet e Bankës.

Qeverisja e informatave e bazuar në përgjegjësi

Për të siguruar fshehtësinë, integritetin dhe disponueshmërinë e informatave dhe sistemeve të informacionit, Banka përdor qeverisjen e informacionit të bazuar në përgjegjësi. Sipas këtij programi, ne përpiqemi për të balancuar mbrojtjen e informacionit, sigurinë dhe biznesin, ndërsa veprojmë konform dhe respektojmë të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe standardet më të larta ndërkombëtare.

Ne kemi vendosur rregulloret e brendshme të plota për të mbrojtur informatat dhe kemi përfshirë mbrojtjen e informacionit në të gjitha proceset e punës që direkt ose indirekt kërkojnë mbledhjen, përpunimin, qasjen, analizën, shpalosjen ose shkatërrimin e çdo informacioni. Qasja në informacion është rreptësisht e kufizuar vetëm për punë ose në bazë të nevojës për ta ditur ndërsa shpalosja dhe shpërndarja e të dhënave është e rregulluar në përputhje me kërkesat ligjore dhe miratimin dhe autorizimin individual.

NE KEMI VENDOSUR KONTROLLE TË PËRPIKTA PËR TË MBROJTUR TË DREJTËN E INDIVIDIT PËR PRIVATËSI, DINJITET DHE SIGURI.

Mbrojtja e të dhënave personale

Një sasi e madhe e informacionit që ne e ruajmë janë të dhënat personale të klientëve tanë. Ato mblidhen, përpunohen dhe ruhen si pjesë e marrëveshjes kontraktuale të Bankës me klientin për të ofruar dhe për të përdorur produktet dhe shërbimet bankare. Ne me zell i mbrojmë të gjitha të dhënat tona dhe kemi vendosur kontrole të përpikta për të mbrojtur të drejtën e individit për privatësi, dinjitet dhe siguri.

Ne mbrojmë të dhënat personale me të gjitha mjetet në dispozicion dhe kemi qëllim ta bëjmë këtë për aq kohë sa të dhënat të jenë nën përkujdesjen tonë. Megjithatë, ne mund të shpalosim të dhënat nëse dhe kur kërkohet me ligj, ose me pëlqimin e individit, por jo përtej asaj që është e nevojshme për të ofruar një produkt apo shërbim. Klientët individualë mund të autorizojnë edhe delegimin e informacionit për një individ tjetër.

Gjatë vitit 2014, ne kemi zbatuar një proces të drejtpërdrejtë të marketingut që i lejon klientët të refuzojnë ofertat e marketingut përmes SMS-së, nëse ata parapëlqejnë kështu. Kjo është zbatuar sipas Aktit të komunikimeve elektronike, neni 92, Komunikimet e padëshiruara. Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale arriti në përfundimin se Banka është në përputhje me këtë legjislacion.

Programet e trajnimit të Bankës përfshijnë trajnimin e detyrueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave. Qëllimi i trajnimit është që të sigurojë një kuptim bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave në mënyrë që ne të mund të ushtrojmë përgjegjësinë tonë në mbrojtjen e të drejtave dhe privatësinë e individëve gjatë trajtimit të të dhënave personale. Gjatë vitit 2014, 521 punonjës morën pjesë në këtë trajnim.

BORDI I DREJTORËVE

MUSA ERDEN

Kryetar

I lindur në Hataj, Turqi në vitin 1950, Musa Erden diplomoi në Akademinë e Shkencave Ekonomike dhe Tregtare të Ankarasë, Departamenti Bankar. Ai e filloi karrierën e tij në bankën Yapi Kredi në vitin 1972. Ai iu bashkua bankës Osmanli në vitin 1973, ku deri në vitin 2001 mbajti poste të ndryshme, si Asistent Menaxher i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm (BD/CM), dhe Koordinator. Ai shërbeu si anëtar i Komitetit të Arbitrazhit të Shoqatës së Bankave Turke nga viti 2002 deri në vitin 2003; si Drejtor i MNG Bank në vitin 2003; si Kryetar i të katër kompanive Turistike të ndërtimit të strukturës osmane; dhe si Drejtor i Fondit Otoman Ltd nga 2006 deri më 2008. Në vitin 2005 iu bashkua TEB Grupit si Auditor i TEB A.Ş. dhe TEB Investimet financiare dhe ka shërbyer si konsulent nga viti 2006 deri në emërimin e tij të tanishëm si anëtar i Bordit Ekzekutiv të TEB A.Ş. në vitin 2008. Z. Erden u emërua Kryetar i Bordit të Drejtorëve të TEB Sh.A në dhjetor të vitit 2010. Nga marsi 2011, ai është edhe ushtrues detyre i Kryetarit të TEB Factoring dhe nga viti 2010 anëtar i Bordit të BNP Paribas Leasing.

ALP YILMAZ

Zëvendës Kryetar

I lindur në Stamboll, Turqi në vitin 1965, Alp Yilmaz diplomoi në Fakultetin e Administratës së Biznesit në Universitetin Dokuz Eylul, dhe mori titullin Master në Fakultetin e Shkencave Administrative (Administrim Biznesi) në Universitetin e Stambollit. Karrierën e tij profesionale e filloi si analist financiar në vitin 1991 në Bankën Turke të Zhvillimit Industrial. Ai ka shërbyer si auditor në Kocbank A.Ş. nga 1992 deri më 1995. Ai iu bashkua TEB A.Ş. në vitin 1997 dhe ka punuar në Departamente të ndryshme, duke përfshirë Shitje dhe Marketing, Buxhet dhe Kontroll Financiar dhe Menaxhim të parasë. Nga viti 2007 deri në vitin 2012, shërbeu si anëtar i Bordit dhe Kryeshef Ekzekutiv në TEB Sh.A, dhe gjatë qëndrimit të tij ka qenë edhe Zëvendës-Kryetar i Odës Ekonomike të Turqisë dhe Kosovës, anëtar i Bordit të Odës Ekonomike të Francës dhe Kosovës dhe anëtar i Bordit të Shoqatës së Bankierëve të Kosovës. Në janar të vitit 2013, ai dha dorëheqjen si KSHE i TEB Sh.A për t'u emëruar si Këshilltar i KSHE të TEB A.S (Turqi). Nga 11 prilli i vitit 2013, ai u emërua si Zëvendës-Kryetar i TEB Sh.A. dhe Kryetar i Komitetit për Paga i TEB Sh.A.

AYSE ASARDAĞ

Anëtar i bordit

E lindur në Ankara, Turqi në vitin 1964, Ayşe Aşardağ diplomoi në Departamentin e Administrimit të Biznesit të Universitetit Bogaziçi në vitin 1987. Ajo u çertifikua si një kontabiliste e çertifikuar nga ana e Institutit të Kontabilistëve të Çertifikuar të Anglisë dhe Uellsit, ACCA, në vitin 1992. Ajo filloi karrierën e saj profesionale në Price Waterhouse dhe punoi në Njësinë e Auditimit për të dy zyrat, të Stambollit dhe të Londrës nga 1987 deri më 1994. Znj. Aşardağ ishte një Ligjëruese e lëndës së Kontabilitetit në Universitetin e Glamorgan nga 1994 deri më 1995. Në vitin 1995, ajo iu bashkua Njësisë për Buxhet dhe Kontroll Financiar të TEB-it deri në vitin 2001. Që nga atëherë, ajo ka qenë Kryeshefe Financiare e Grupit TEB në TEB Holding. Znj. Aşardağ aktualisht shërben si anëtare e Bordit të TEB A.Ş., anëtare e Bordit dhe anëtare e Komitetit të Auditimit të TEB NV, TEB Factoring dhe TEB Investimet, dhe është anëtare e Bordit të Menaxhimit të Aseteve të TEB. Ajo u emërua si Zëvendës-Kryetare e TEB Sh.A në vitin 2007. Nga dhjetori 2007, Znj. Aşardağ është një anëtare e Bordit dhe Kryetare e Komitetit të Auditimit të TEB Sh.A.

TUGBAY KUMOĞLU

Anëtar i bordit

I lindur në Antalia, Turqi në vitin 1974, Tugbay Kumoglu diplomoi në Fakultetin Ekonomik dhe Shkenca Administrative të Universitetit Gazi. Ai e filloi karrierën e tij profesionale në Garanti Bank si kandidat për trajnim për menaxhment në vitin 1998. Pas mbajtjes së disa pozitave në degët dhe organizatat rajonale në Garanti, ai u emërua si Drejtor i Planifikimit Strategjik të Shërbimeve bankare për NVM. Posti i tij i fundit ishte në Garanti Bank si menaxher i degës. Ai iu bashkua TEB Group në vitin 2006 si Menaxher i 2 i Shitjeve Rajonale për Evropë. Në vitin 2007, ai u gradua si Drejtor i menaxhimit të shitjeve individuale të TEB. Nga viti 2011, ai gjithashtu është përgjegjës për menaxhimin e performancës së shërbimeve bankare për individë dhe star, Financave të konsumatorit, Ekipit për shitje të drejtpërdrejta dhe Pagesat e rrogave të punëtorëve. Nga shkurti i vitit 2013, z. Kumoglu është emëruar si anëtar i Bordit të TEB Sh.A.

Dr. MEHMET OZKAYA**Anëtar i bordit**

I lindur në Konia, Turqi në vitin 1969, Dr Mehmet Ozkaya ka fituar titullin e doktoraturës në Financat Ndërkombëtare (1999) dhe diplomën MBA në Vendim-marrje Financiare (1994) në Universiteti George Washington në Shtetet e Bashkuara, dhe diplomën BSc në Inxhinieri Kompiuterike (1992) në Universiteti Bogazici në Turqi.

Z. Ozkaya ka shpenzuar pjesën e hershme të karrierës së tij në Thesarin e Bankës Botërore në SHBA. Gjatë qëndrimit të tij atje nga viti 1995 deri më 2006, ai mbajti poste të ndryshme, duke përfshirë Shef i të ardhurave fikse globale në Investimet e Fondit Pensional (2003-2006), Zyrtar i lartë financiar në tregjet e kapitalit (2000-2002), Zyrtar financiar në financat e strukturuar dhe derivateve (1998-1999), dhe Analist financiar i Menaxhimit të asetëve dhe përgjegjësi (1995-1997).

Z. Ozkaya iu bashkua TEB Group në fillim të vitit 2006 si Kryeshef për investime i menaxhimit të asetëve të TEB ku ai gjithashtu e këshilloi Kryetarin dhe KSHE të TEB Group për tregjet globale, ekonomitë ndërkombëtare, dhe menaxhimin e portofolit të investimeve të TEB. Në vitin 2011, ai u emërua si Kryeshef për investime në TEB A.Ş. Që nga prilli i vitit 2013, z. Ozkaya ka shërbyer si anëtar i Bordit dhe Kryetar i Komitetit të MAD-së të TEB Sh.A.

SABRİ DAVAZ**Anëtar i bordit**

I lindur në Bandirma, Turqi në vitin 1963, Sabri Davaz diplomoi në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Ankarasë dhe mori titullin Master në Ekonomi Financiare nga Universiteti i Bostonit në vitin 2000. Ai e filloi karrierën e tij profesionale në vitin 1985 në Nën-sekretariatit e Thesarit në Turqi, ku ai shërbeu në disa pozita deri në vitin 2004, duke përfshirë edhe pozitën e krye auditorit të Sworn Bank, Zëvendës-Kryetar i Bordit të Auditorëve të Sworn Bank, Auditor i Sworn Bank.. Nga viti 2004 deri në 2009 ai ishte Zëvendës-kryetar për Rregullore bankare dhe i Agjencisë së Mbikëqyrjes e Turqisë, gjithashtu duke vepruar si konsulent deri në vitin 2011 kur ai u bashkua me grupin TEB si Këshilltari kryesor i Kryesuesit në TEB Holding A.Ş.

Nga marsi i vitit 2012, ai është anëtar i Bordit të TEB A.Ş. dhe nga shkurti i vitit 2013 ai shërben si anëtar i Komitetit të Auditimit të TEB A.Ş. Në prill të vitit 2013, ai u emërua si anëtar i Bordit dhe Zëvendës-kryetar i Komitetit të Auditimit të TEB Sh.A.

PASCAL ALFRED J. GILLIARD**Anëtar i bordit**

I lindur në Leuven, Belgjikë në vitin 1967, Pascal Gilliard diplomoi në degën Inxhinieri e biznesit në Universitetin e Brukselit.

Ai e filloi karrierën e tij profesionale si kandidat për trajnim për menaxhment në Generale Bank në vitin 1990.

Ka mbajtur disa pozita duke përfshirë Menaxher i degës, Menaxher i lartë për marrëdhënie me korporata, dhe Zyrtar për financat e strukturuar deri në shkrimin me kompaninë Fortis. Pastaj, z. Gilliard shërbeu si Zyrtar për shitjen e instrumenteve financiare me të ardhura fikse dhe Bankier i lartë për institucione financiare. Në vitin 2006, ai u transferua në Hong Kong si kryesues i Grupit të institucioneve financiare të Azisë dhe në vitin 2008 u bë kryesues global i institucioneve financiare jobankare.

Si rrjedhojë e shkrirjes me BNP Paribas, në vitin 2010, ai iu bashkua Grupit për menaxhimin e rrezikut në Paris ku ai vepronte si Zyrtar i lartë për kredi për klientët francezë të CIB-së. Aktualisht mban pozitën e Kryeshefit të grupit të rrezikut të TEB-it në Turqi. Që nga viti 2014, ai është anëtar i Bordit dhe anëtar i Komitetit të auditimit të TEB-it, dhe kryeson Komitetin e menaxhimit të rrezikut.

KOMITETET

TEB Sh.A. Bordi i Drejtorëve

Kryesuesi: **Musa Erden**

Zëvendës Kryetar: **Alp Yılmaz**

Anëtar: **Ayşe Aşardağ**

Anëtar: **Pascal Alfred J. Gilliard**

Anëtar: **Sabri Davaz**

Anëtar: **Tugbay Kumoglu**

Anëtar: **Mehmet Ozkaya**

Anëtar: **Ayhan Albeyoğlu** (ex-officio)

Menaxhimi

TEB Sh.A (Banka/TEB-i) ka një Bord të drejtorëve aktualisht të përbërë nga tetë anëtarë, të gjithë me përvojë të madhe bankare (ju lutem shihni biografite e anëtarëve). Bordi kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me kërkesat e përcaktuara në statutin e Bankës dhe rregulloret e Bordit të Drejtorëve dhe në përputhje me të gjithë legjislacionin përkatës dhe kërkesat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullatorët. Bordi mblidhet të paktën çdo tre muaj.

Roli i Bordit të Drejtorëve

Detyra kryesore e Bordit është të mbikëqyrë aktivitetet financiare dhe afariste të Bankës. Ai është përgjegjës për përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Bankës, politikës afariste të saj duke përfshirë njësitë operative dhe administrative, nën-njësitë dhe funksionet

e tyre, pozitat mbikëqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese. Për më tepër, Bordi është i ngarkuar edhe me mbikëqyrjen e aktiviteteve të menaxhmentit të lartë. Bordi i Drejtorëve përcakton dhe krijon strukturën bankare dhe nivelet e ekspozimit të bankës, rishikon dhe miraton rregullimet dhe masat e nevojshme. Për më tepër, Bordi është përgjegjës për miratimin e raportit të menaxhmentit të lartë për aktivitetet e biznesit në bazë të bilancit gjashtëmuor të gjendjes, pasqyrës së fitimit dhe humbjes, bilancit vjetor të gjendjes dhe raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Vendimet e marra nga Bordi kërkojnë shumicën e votave nga anëtarët të cilët ose janë të pranishëm ose votojnë me ndërmjetës.

Komitetet e bordit të TEB Sh.A

Në përputhje me statutin dhe rregulloret e saj, Bordi ynë ka emëruar një komitet të auditimit, një komitet të menaxhimit të rrezikut, një komision për asete dhe detyrime, një komitet të kompensimit dhe komitete të tjera të përherëshme të përbëra nga anëtarët e Bordit dhe ekspertë të jashtëm. Komiteti i kompensimit dhe komiteti i menaxhimit të rrezikut janë caktuar në takimet e Bordit të Drejtorëve më 2 nëntor dhe 20 dhjetor 2012, respektivisht. Bordi gjithashtu mund të krijojë komisione **ad hoc** dhe të përcaktojë përbërjen dhe detyrat e tyre, aty ku duhet dhe është e përshtatshme.

Komiteti i Auditimit

Kryesuesi: **Ayşe Aşardağ**

Zëvendës Kryetar: **Sabri Davaz**

Anëtar: **Pascal Alfred J. Gilliard**

Anëtar: **Nexhat Kryeziu** (ekspert i jashtëm)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Komiteti i Auditimit ka detyrat dhe përgjegjësitë e qarta që janë të përcaktuara në aktet nënligjore të komiteteve të auditimit dhe janë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregulloret. Detyrat e tij përfshijnë:

- Rekomandimi i kontrolleve adekuate të brendshme të kontabilitetit, operative dhe administrative;
- Mbikëqyrja e përputhshmërisë së Bankës me politikat dhe procedurat;
- Kërkesa dhe rishikimi i raporteve nga shefi i departamentit të auditimit të brendshëm të Bankës;
- Rekomandimi i kompensimit për shefin e departamentit të auditimit të brendshëm;
- Monitorimi i përputhshmërisë me legjislacionin bankar përkatës dhe rregulloret e aplikueshme ose kërkesat;
- Rekomandimi për emërimin e një auditori të jashtëm;
- Monitorimi i performancës së auditorit të jashtëm, rishikimi i raportit të auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të Bankës dhe raportimi i të gjitha gjetjeve tek Bordi i Drejtorëve;
- Shpërndarja e opinioneve tek Bordi i Drejtorëve në lidhje me çdo çështje që i kërkohet atij nga Bordi i Drejtorëve, ose që komisioni dëshiron ta adresojë; dhe
- Miratimi i planit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm të TEB Sh.A.

Komiteti i auditimit takohet së paku çdo tre muaj.

Komiteti i menaxhimit të rrezikut të kredive

Kryesuesi: **Jean-Milan Givadinovitch**

Zëvendës Kryetari: **Murat Akşam**

Anëtar: **Alp Yılmaz**

Anëtar: **Haluk Kırçalı**

Anëtar: **Ali İhsan Arıdaşır**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Ky komitet është i autorizuar të marrë vendime për kredi për shumat në mes 500,000 € dhe 2.5 milion €.

Komiteti i Menaxhimit të Aseteve dhe Detyrimeve (KAD)

Kryesuesi: **Mehmet Ozkaya**

Zëvendës Kryetari: **Ayhan Albeyoglu**

Anëtar: **Alp Yılmaz**

Anëtar: **Pascal Alfred J. Gilliard**

Anëtar: **Tolga Gürdem**

Anëtar: **Arif Bibioğlu**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Monitorimi i tregjeve financiare, duke kontrolluar situatën, lëvizjet dhe ndryshimet në bilancin e gjendjes së bankës dhe marrjen e vendimeve, të gjitha në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Bankës;
- Udhëzimi dhe monitorimi i veprimeve të Departamentit të Thesarit dhe MAD-së në mënyrë të vazhdueshme dhe duke vepruar si organ vendim-marrës, siç përcaktohet në aktet nënligjore të Komisionit për MAD;
- Mbikëqyrja e menaxhimit të asetëve dhe (borxheve) detyrimeve nga ana e Departamentit të Thesarit dhe MAD-së në drejtim të kriterëve të mëposhtme:
- Për të siguruar respektimin e raporteve të jashtme (rregullative) të përcaktuara nga BQK-ja dhe rregullave të brendshme të përcaktuara nga Bordi ose KAD-i;
- Monitorimi i rezervave së domosdoshme minimale të përcaktuar nga BQK-ja.

Komiteti për asete dhe detyrime takohet së paku çdo tre muaj.

KOMITETET

Komiteti i menaxhimit të rrezikut (KMRr)

Kryesuesi: **Pascal Alfred J. Gilliard**

Zëvendës Kryetari: **Alp Yilmaz**

Anëtar: **Musa Erden**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut është përgjegjës për monitorimin e të gjitha komponentëve të lidhura me rrezikun dhe funksionet që kanë të bëjnë me kreditë, tregun, likuiditetin, çështjet operationale, përputhshmërinë, reputacionin, çështjet ligjore, mosshlyerjen e pagesave, mjaftueshmërinë e kapitalit të Bankës dhe rreziqet e tjera.

Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut takohet së paku çdo tre muaj.

Komiteti i kompensimit

Kryesuesi: **Alp Yilmaz**

Zëvendës Kryetari: **Ayşe Aşardağ**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Përgjegjësitë e këtij komiteti përfshijnë detyrat e mëposhtme:

- Propozimet për zbatimin e Politikës së Bankës për kompensimin për Bordin;
- Propozon një politikë/sistem para Bordit në lidhje me vlerësimin e performancës dhe caktimin e synimeve për menaxhmentin e lartë;
- Propozon për Bordin kriteret e vlerësimit të performancës vjetore dhe afatgjatë dhe objektivat për menaxhmentin e lartë;
- Të paktën një herë në vit (mundësisht në tremujorin e parë të çdo viti), shqyrton dhe miraton vlerësimet përmbledhëse të performancës, objektivat dhe propozimin për pakon kompensuese për menaxhmentin e lartë;
- Jep propozime për Bordin në lidhje me pakon e kompensimit për drejtuesit ekzekutivë; dhe
- Jep raportet për Bordin e Drejtorëve mbi kompensimin në baza vjetore ose sipas kërkesës.

Komiteti i kompensimit takohet së paku një herë në vit.

AUDITIMI I BRENDSHËM

Auditimi i Brendshëm

Bordi i Drejtorëve të TEB Sh.A. ka themeluar Departamentin e Auditimit të Brendshëm në shkurt 2013 si një nga faktorët kryesorë në strukturën qeverisëse të Bankës. Para kësaj date, Banka kishte kontraktuar funksionin e saj të auditimit të brendshëm te Turk Ekonomi Bankasi A.Ş., në bazë të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (SLA) të nënshkruar në vitin 2008. Banka vazhdon të marrë përkrahje për auditim nga TEB A.Ş. përmes këshillave të auditimit për Departamentin e Auditimit të Brendshëm. Për më tepër, TEB A.Ş. kryen auditime specifike për aktivitetet e caktuara, bazuar në planet e para-përgatitura të auditimit. Departamenti i Auditimit të Brendshëm të Bankës është i pavarur dhe si i tillë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit dhe me iniciativën e vet, nëse e sheh të nevojshme ose të përshtatshme.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm posedon funksion të sigurisë, duke i ndihmuar Bankës për të përmbushur objektivat e saj, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar ndaj vlerësimit dhe përmirësimit të efektivitetit të mjedisit të kontrollit, duke përfshirë proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes. Është përgjegjësi e Auditimit të Brendshëm për të vlerësuar

nëse mjedisi i kontrollit siguron se rreziqet që mund të lindin nga aktivitetet e Bankës menaxhohen në mënyrën e cila mundëson një nivel të pranueshëm të uljes së rrezikut. Aktivitetet e auditimit kryhen nga departamenti i auditimit të brendshëm sipas planit të auditimit, i cili përgatitet të paktën një herë në vit duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Bankës. Secili plan i auditimit miratohet nga Komiteti i Auditimit i Bankës. Plani azhurnohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për të integruar linja të reja të biznesit. Në të njëjtën mënyrë, auditori i brendshëm përgjegjës zhvillon dhe regjistron një plan të fokusuar në rrezik për çdo detyrë të auditimit, i cili analizon pikat e brendshme të rrezikut dhe përfshin objektivat, fushëveprimin, kohën dhe ndarjen e burimeve.

Puna e Departamentit të Auditimit të Brendshëm kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të hartuara nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm, i cili është organi drejtues për profesionin e auditimit të brendshëm në të gjithë botën, dhe me praktikatat e auditimit të TEB A.Ş..

MENAXHIMI I RREZIKUT

TEB Sh.A ka një qasje gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme sa i përket rrezikut, identifikimit dhe menaxhimit të tij. TEB Sh.A monitoron dhe vlerëson rrezikun e tregut, likuiditetit, të normave të interesit, rrezikun operacional dhe rreziqe tjera përkatëse (financiare) duke përdorur metodat që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Procesi i menaxhimit të rrezikut është i organizuar në strukturën e metodologjive të menaxhimit të rrezikut të TEB dhe BNP Paribas (MRG dhe IRB, respektivisht) dhe favorizon një kulturë të përbashkët të menaxhimit të rrezikut. Procesi është i përbërë nga përkufizimi dhe matjet e rrezikut, themelimi i politikave dhe procedurave të rrezikut, analiza e rrezikut dhe monitorimi, raportimi, si dhe fazat e auditimit. Menaxhmenti i Rrezikut në Grup (MRG) mbikëqyr procesin e përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut në kuadër të TEB Group. Puna e departamentit të menaxhimit të rrezikut në TEB Sh.A. është të punojë në bashkëpunim me menaxhmentin ekzekutiv për të siguruar se rreziqet që i merr TEB Sh.A janë në pajtim me politikat e MRG-së dhe se janë në përputhje me objektivat e profitabilitetit dhe të klasifikimit kreditor. Menaxhimi i Rrezikut raporton rregullisht pranë Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut për të gjitha rreziqet relevante financiare. Ja një pasqyrë e rreziqeve më të rëndësishme dhe veprimeve që ne i bëjmë për t'i ulur ato.

Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normave të interesit vjen nga mundësia që ndryshimet në normat e interesit mund të ndikojnë në fitimin e ardhshëm ose vlerën e instrumenteve financiare. Mbrojtja ndaj ndryshimeve në normat e interesit është një prioritet i lartë për TEB Sh.A.

Ulja: Rreziku i normave të interesit përcaktohet duke matur shkallën e ndjeshmërisë së asetëve, detyrimeve dhe zërave jashtë-bilancorë. Kjo monitorohet nga afër përmes analizave të hendekut dhe të kohëzgjatjes. Simulimet mbi të hyrat nga interesi kryhen në lidhje me indikatorët e parashikuar ekonomikë të përdorur në buxhetin e Bankës. Efektet e mundshme negative të luhatjes së normës së interesit në pozicionin financiar dhe rrjedhën e parave minimizohen me anë të vendimeve të shpejta.

Në përcaktimin e strategjive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate të çmimeve, Komiteti i asetëve dhe detyrimeve të TEB Sh.A menaxhon mospërputhjen e maturimeve dhe përdorë parimin e punës me margjina pozitive të bilancit të gjendjes si politikën e saj të çmimeve.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin humbjet e mundshme që një bankë mund të pësojë si pasojë e ekspozimit të zërave të bilancit të gjendjes dhe zërave jashtë-bilancorë të saj ndaj rrezikut të normës së interesit, rrezikut të pozicionit të ekuitetit ose rrezikut të kursit të këmbimit që rezultojnë nga luhatjet në tregjet financiare.

Ulja: Menaxhimi i rrezikut të tregut në TEB Sh.A është dizajnuar që të kontrollojë dhe menaxhojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut, në mënyrë që të optimizohen kthimet duke e ruajtur profilin konservativ të Bankës sa i përket rrezikut.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit ndodh kur nuk ka para të mjaftueshme ose rrjedhë të mjaftueshme të parasë për t'i përmbushur kërkesat neto të fondeve në kohën e duhur. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë edhe kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllen shpejt me çmime të përshtatshme.

Ulja: Politika e Bankës është të krijojë një strukturë të mjeteve që është mjaft likuide për t'i përmbushur të gjitha llojet e detyrimeve kur ato duhen paguar. Bordi i Drejtorëve rregullisht monitoron dhe përcakton normat e likuiditetit dhe standardet përkatëse për ruajtjen e likuiditetit të lartë gjatë gjithë kohës. TEB Sh.A ka një sistem efikas sa i përket raportimit me kohë të pozicionit të likuiditetit te Bordi i Drejtorëve, te Menaxhmenti i lartë dhe te të gjitha njësitë përkatëse.

Rreziku i Kredive

Rreziku i kredive është humbja që mund të ndodhë nëse pala tjetër në marrëdhënie të kredisë dështon, pjesërisht ose tërësisht, për t'i përmbushur detyrimet e saj në kohë. TEB Group është i ekspozuar ndaj rrezikut të

kredisë nëpërmjet kreditimit të saj, financave tregtare dhe aktiviteteve të thesarit, por rreziku i kredive mund të lindë edhe në rrethana të tjera.

Ulja: Bordi i Drejtorëve ka autoritetin vendimtar në lëshimin e kredive. Kjo fuqi i është deleguar Komitetit të Kredive dhe kryeshefit ekzekutiv në kushte të caktuara. Ushtrimi i këtyre kompetencave të deleguara monitorohet dhe raportohet rregullisht nga auditimi i brendshëm dhe menaxhimi i rrezikut. Ekspozimi primar ndaj rrezikut të kredisë në TEB Sh.A lind nëpërmjet kredive të saj dhe paradhënies për klientët. Shuma e ekspozimit kreditor në këtë drejtim është një funksion i mbajtjes së asetëve në bilancin e gjendjes të konsoliduar. Përqendrimet e rrezikut të kredisë mund të lindin kur një numër i klientëve janë të angazhuar në aktivitetet e ngjashme të biznesit, apo aktivitete në të njëjtin rajon gjeografik, ose kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të bënin që aftësitë e tyre për t'i përmbushur detyrimet kontraktuese të ndikohen në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet ekonomike, politike ose kushte të tjera. Zyrtarët e degës vizitojnë aplikuesit e kredisë dhe marrin pasqyrat financiare dhe informacionin në lidhje me aktivitetet dhe planet e klientit potencial. Përgatitet një propozim kredi që përmban një koment mbi pozicionin financiar të kompanisë, një analizë të industrisë, informacion në lidhje me partnerët dhe menaxherët, si dhe referenca nga bankat e tjera dhe kompanitë me të cilat aplikanti është duke bërë biznes. Ky informacion më pas i dorëzohet Divizionit për Alokim dhe Monitorim të Kredive që vlerëson besueshmërinë e aplikuesit dhe raportin e tij e dërgon në Komitetin Kreditor për aprovim.

Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut rregullisht vlerëson dhe menaxhon të gjitha rreziqet financiare, përfshirë rrezikun kreditor. Bën vlerësimin e rrezikut të brendshëm në nivel të bankës dhe në nivel të njërive punuese të paktën dy herë në vit. Analiza e nivelit të bankës duhet të shqyrtohet sa herë që ekziston një ndryshim i rëndësishëm në mjedisin operativ që mund të ndikojë në TEB Sh.A. Zhvillimet në treg monitorohen nga afër për ta minimizuar rrezikun kreditor. Si rezultat i politikës së kujdeshme që Banka miraton, kredia më e madhe që një klient mund të marrë mbahet

nën kufijtë ligjor, duke minimizuar kështu rrezikun e përqendrimit të kredisë. Kufijtë e vendosur nga Bordi i Drejtorëve monitorohen dhe raportohen rregullisht. Divizioni për Lëshimin dhe Monitorimin e Kredive bën vlerësime të portofolit të kredisë për Komitetin e kredisë dhe menaxhimit të rrezikut si dhe raporton rastet e rrezikut të lartë dhe kreditë joperformuese. Pasi ofrohet një produkt kreditor, Departamenti për Monitorim të Kredive monitoron aftësinë e klientit për shlyerje dhe mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e kolateralit. Në këtë mënyrë, çdo hua problematike identifikohet në një fazë të hershme. Nëse vlerësimi kreditor dhe/ose cilësia e kolateralit ka ngritur ndonjë dyshim, klienti shqyrtohet më hollësisht.

Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i këmbimit valutor përcaktohet si një humbje e mundshme që një bankë mund të pësojë me të gjitha mjetet dhe detyrimet e saj në valuta të tjera në rast të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Ulja: Kufijtë e pozitive të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve monitorohen në baza ditore dhe ndryshimet e mundshme në pozitat monetare të Bankës që mund të vijnë si rezultat i transaksioneve rutinore në valuta të huaja gjithashtu kontrollohen.

Adekuatshmëria e kapitalit

Qëllimi i bankës është që vazhdimisht të sigurohet se ka kapital të mjaftueshëm për të mbuluar rreziqet që shoqërojnë punën e bankës. Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut monitoron dhe raporton normat e adekuatshmërisë së kapitalit pranë Menaxhmentit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut. Sipas Ligjit për veprimtarinë bankare dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës, ka tre raporte të adekuatshmërisë që duhet të plotësohen në çdo kohë: Kapitali i klasit të parë në raport me asetet e peshuara me rrezik duhet të jetë të paktën 8%, kapitali total në raport me asetet e peshuara me rrezik duhet të jetë së paku 12% dhe totali i ekuitetit në raport me asetet totale prej më së paku 7%.

PAJTUESHMËRIA, KONTROLLI I BRENDSHËM DHE RREZIKU OPERACIONAL

Pajtueshmëria

Ne jemi të përkushtuar për aktivitete bankare të përgjegjshme dhe për të vepruar me integritet dhe përgjegjësi në çdo gjë që bëjmë. Në TEB, ne besojmë se në krijimin e vlerës për klientët tanë, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë, mënyra se si ne kryejmë afarizmin është po aq e rëndësishme sa qëndrueshmëria e rritjes së biznesit tonë. Nënkuptohej se respektimi i ligjeve dhe zbatimi i rregulloreve dhe standardeve dhe udhëzimeve më të larta ndërkombëtare është pjesë e identitetit tonë dhe formon themelin për mënyrën se si ne bëjmë biznes. Në të njëjtën kohë, ne kemi vendosur standarde të larta të integritetit të biznesit dhe sjelljes etike për qëllim rritjen e efektivitetit të kornizës së pajtueshmërisë.

Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të vazhdueshme në kërkesat rregullative të mjedisit në Kosovë, ku menaxhimi i pajtueshmërisë është duke u bërë prioritet kryesor. Këtë vit në 2014, ne jemi ballafaquar me shumë sfida, por ne vlerësojmë kontrollin e rritur nga qeveria dhe ndryshimet rregullative. Fryma jonë ekipore, përkushtimi dhe përmirësimi i qëndrueshëm i efikasitetit tonë të gjitha kanë për qëllim ruajtjen e integritetit të institucionit tonë financiar.

Ne presim që punonjësit tanë të veprojnë me ndershmëri, me përgjegjësi, në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë profesionale, në shërbim të interesave më të mira të klientëve dhe për të respektuar integritetin e tregjeve. Kodi ynë i sjelljes, i përbërë nga vlerat tona, sjellja dhe kërkesat etike në biznes, formon bazën për mënyrën se si punonjësit tanë duhet të sillen me kolegët dhe klientët tanë, partnerët afaristë, aksionarët dhe autoritetet. Kodi i mirësjelljes përfshinë dispozitat etike në biznes që kanë për qëllim menaxhimin e konfliktit të interesit, parandalimin e abuzimit të tregut, luftimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera ekonomike.

Ne jemi të përkushtuar për të respektuar ligjet e rrepta, rregulloret dhe udhëzimet për të luftuar shpërlarjen e parave, financimin e terrorizmit dhe aktet e tjera kriminale. Ne analizojmë klientët tanë dhe transaksionet e tyre për të parandaluar që emri ynë dhe produktet dhe shërbimet

tona të mos keqpërdoren për qëllime të tilla. Për këtë qëllim, ne zbatojmë masa të përpikta të përkrahura nga sistemet automatike të monitorimit dhe procesin "njihe klientin tënd" (NjKT). Procesi ynë NjKT vepron si bazë për mënyrën se si ne menaxhojmë rreziqet që mund të shfaqen nga lidhja e marrëdhënies me një klient të ri ose nga ofrimi i shërbimeve një klienti ekzistues. Procesi fillon me një vlerësim para pranimit të çdo klienti të mundshëm të ri dhe vazhdon në formën e rishikimeve të rregullta, sipas procedurave të përcaktuara dhe duke përfshirë vlerësimin e njerëzve apo subjekteve që janë pronarët e fundit përfitues.

Masat parandaluese dhe zbatimi i kontrolleve të hollësishme na ndihmojnë të mbajmë respektimin rigoroz të ligjeve dhe rregulloreve. Prandaj, në vitin 2014 ne kemi realizuar disa projekte të rëndësishme për të forcuar infrastrukturën tonë të TI-së dhe qasjet ndër-funksionale për etikën e punës, shpërlarjen e parave dhe konfliktin e interesit, dhe do të vazhdojmë me projekte të ngjashme në të ardhmen.

Me qëllim të promovimit të programit tonë të pajtueshmërisë dhe për të siguruar ndërgjegjësimin dhe respektimin nga punonjësit tanë, ne kemi zgjeruar programin tonë të trajnimit për të përfshirë mësimin elektronik (e-learning) dhe module të veçanta për temat kryesore të pajtueshmërisë. Modulet janë në dispozicion për të gjithë të punësuarit dhe mund të përshtaten me nevojat e linjave tona të biznesit në përputhje me kërkesat specifike të punës. Ata gjithashtu plotësojnë gamën e gjerë të programeve të trajnimit në vend që adresojnë tema të pajtueshmërisë. Shumica e disiplinave të mbuluara nga modulet profesionale janë të bazuara në konceptet e përbashkëta të transparencës.

Departamenti ynë i Pajtueshmërisë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit. Qëllimi i tij është të menaxhojë rrezikun e pajtueshmërisë në mënyrë të duhur për të siguruar që aktivitetet bankare janë në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret përkatëse.

Duke parashikuar ndikimin e sfidave të sotme financiare dhe situatave të paparashikueshme që mund të shfaqen,

Departamenti ynë i pajtueshmërisë vazhdimisht dhe në mënyrë proaktive planifikon, përmirëson dhe identifikon masat parandaluese të rrezikut.

Kontrolli i Brendshëm

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm siguron që një mjedis i shëndoshë i kontrollit të brendshëm është i vendosur në TEB Sh.A. Ai merret me koordinimin thelbësor dhe garanton se aktivitetet e ndërlidhura kryhen rregullisht, në mënyrë efikase, efektive dhe në përputhje me strategjinë e menaxhmentit dhe politikat e Bankës, si dhe me rregullat dhe rregulloret në fuqi. Pas ndryshimeve organizative gjatë vitit, funksionet e Kontrollit të brendshëm dhe Rrezikut operacional tani janë të strukturuar veçmas. Brenda fushëveprimit të kontrollit të brendshëm, kontrollet e përditshme, javore, kontrollet mujore dhe tremujore të aktiviteteve kritike në degë dhe departamentet e zyrës qendrore kryhen nga njësia e kontrollit të degës dhe njësia qendrore e kontrollit.

Kontrolluesi kryen kontrollet e tij/saj në pajtim me listat e kontrollit të cilat janë të përgatitura paraprakisht dhe në përputhje me rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe të jashtme. Listat e kontrollit rishikohen nëse ndodhin ndryshime në rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe/ose të jashtme.

Pikat e kontrollit në listat e kontrollit përdoren për:

- Verifikimin e respektimit të duhur të rregullave dhe procedurave të brendshme dhe përputhjen e rregullave të brendshme me rregulloret ligjore dhe respektimin e tyre;
- Kontributi për ruajtjen e asetëve;
- Vlerësimi i adekuatshmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të përditshme; dhe
- Kontributi në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të lidhura me aktivitetet afariste aktuale dhe të propozuara të ardhme të organizatës, duke përfshirë produktet e reja.
- Departamenti i Kontrollit të Brendshëm i raporton direkt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit në çdo tre muaj.

Rreziku operacional dhe vazhdimësia e punës

Rreziku operacional përkufizohet si rreziku i humbjes që mund të rezultojë nga proceset e brendshme jo adekuate apo jo funksionale, njerëz apo sisteme, apo nga ngjarje të caktuara të jashtme.

Departamenti i Menaxhimit të rrezikut operacional në TEB është përgjegjës për monitorimin e rrezikut operacional. Ne kemi një sistem të përshtatshëm për natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të Bankës për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe kontrollin/zbutjen në mënyrë efektive të rrezikut përkatës. Ekipi po ashtu është përgjegjës për të ndihmuar departamentet e tjera për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe kontrollin/zvogëlimin e rrezikut operacional; zbatimin e metodave me qëllim të identifikimit, vlerësimit, zvogëlimit (përfshirë kontrollet e brendshme) dhe monitorimit të rrezikut operacional; organizimin e trajnimeve të rrezikut operacional për tërë personelin, sidomos ata përgjegjës për të raportuar ndonjë incident të njësive së rrezikut operacional dhe vazhdimësisë të biznesit; dhe vlerësimin e të gjitha proceseve sa i përket rrezikut operacional dhe identifikimit të ndonjë procesi të rrezikshëm.

Menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit, pavarësisht nga lloji dhe arsyeja e tij, përbëhet tërësisht nga planet që sigurojnë vazhdimësinë e funksioneve kritike të punës së bankës në rast të ndërprerjes së punës ose në rast fatkeqësish. Njësia e Rrezikut Operacional dhe Vazhdimësisë së Biznesit angazhohet vazhdimisht në përkufizimin, matjen dhe raportimin e rrezikut në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm. Rezultatet e aktiviteteve të njësive së rrezikut operacional dhe vazhdimësisë së biznesit rishikohen periodikisht dhe vlerësohen nga Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të TEB-it në emër të Bordit të Drejtorëve.

Rezultatet e Njësive për Rrezikun operacional dhe Vazhdimësinë e Punës shqyrtohen dhe vlerësohen periodikisht nga Komiteti i TEB-it për Menaxhimin e Rrezikut dhe njësia i raporton çdo tre muaj Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit.

TEB SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) PËR VITIN QË PËRFUNDOI MË 31 DHJETOR, 2014

TEB SH.A.

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	52-53
PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE	54
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	55
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	56
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	57
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	58-123

TEB SH.A.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR



Për Aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të TEB Sh. a.

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të TEB Sh. a të cilat përmbajnë pasqyrën e gjendjes financiare më 31 Dhjetor 2014, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrolleve të brendshme të nevojshme për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit; përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e vlerësimeve të arsyeshme kontabël në rrethanat përkatëse.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të përfitur siguri të arsyeshme për mungesën e gabimeve materiale në pasqyrat financiare. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për mbledhjen e evidencave të auditimit që mbështesin shumat dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak mashtrimesh apo gabimesh. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të përcaktuar procedurat e auditimit që i përshtaten rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të mbështetur opinionin tonë.



Opinionit

Sipas opinionit tone, pasqyrat përcjellëse financiare japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të TEB Sh.a më 31 Dhjetor 2014 si dhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k

Prishtinë,

2 Prill, 2015

TEB SH.A.**PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)

	Note	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
ASSETS			
Paraja e gatshme dhe gjendja me bankat	4	67,893	81,152
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	-	17,749
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	287,025	266,060
Pasuritë financiare të gatshme për shitje	8	7,277	825
Pasuritë, prona dhe impiantet	11	4,274	4,453
Pasuirte e paprekshme	12	830	675
Pasuritë tjera financiare	9	1,569	1,345
Tatimi i shtyrë	24	71	-
Pasuritë tjera	10	404	142
Gjithsej pasuritë		369,343	372,401
LIABILITIES			
Detyrimet për klientët	13	314,353	327,232
Detyrimet tjera financiare	14	2,380	1,456
Detyrime të tjera	15	1,102	997
Huamarrjet	16	15,853	16,322
Gjithsej detyrimet		333,688	346,007
KAPITALI			
Kapitali aksionar	17	24,000	24,000
Fitimi/(Humbja) e akumuluar		11,655	2,394
Gjithsej kapitali		35,655	26,394
Gjithsej detyrimet dhe kapitali		369,343	372,401

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga menaxhmenti ekzekutiv i bankës me 18 Shkurt, 2015, dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Z. Ayhan Albeyoglu
Drejtori Menaxhues



Z. Dukagjin Shylemaja
Zëvendës Drejtori Menaxhues

Shënimet shpjeguese nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha vlerat janë në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

	Note	Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2014	Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2013
Të hyrat nga interesi	18	34,106	30,549
Shpenzimet e interesit	19	(5,746)	(9,660)
Të hyrat neto nga interesi		28,360	20,889
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	20	7,602	6,328
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	21	(1,858)	(1,229)
Të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet		5,744	5,099
Fitimi neto nga kursi i këmbimit		250	209
Të hyrat tjera operative		53	98
Shpenzimet e zhvlerësimin për humbjet nga kreditë	6	(8,396)	(7,387)
Humbjet dhe provizionet tjera për Zhvlerësim	7	217	(223)
Shpenzimet e personelit	22	(6,908)	(6,102)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit		(1,819)	(1,844)
Shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera operative	23	(7,170)	(6,535)
Fitimi para tatimit		10,331	4,204
Income tax expense	24	(1,141)	(418)
Deferred income tax		71	-
Fitimi neto i vitit		9,261	3,786
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse		9,261	3,786

Shënimet shpjeguese nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha vlerat janë në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitimi/(Humbja) e akumuluar	Gjithsej
Balance as at January 1, 2013	23,000	(1,392)	21,608
Capital subscribed	1,000	-	1,000
Fitimi neto per vitin	-	3,786	3,786
Të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse	-	3,786	3,786
Gjendja më 31 Dhjetor, 2013	24,000	2,394	26,394
Capital subscribed	-	-	-
Fitimi neto per vitin	-	9,261	9,261
Të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
	-	9,261	9,261
Balance as at 31 Dhjetor 2014	24,000	11,655	35,655

Shënimet shpjeguese nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.**PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)

	Notes	Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2014	Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2013
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		10,331	4,204
Zhvlerësimi	11	1,280	1,382
Amortizimi	12	539	462
Shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë dhe zërat jashtë-bilancor	6,7	8,178	7,610
Humbja nga shitja e asetëve		33	26
Shlyerja e pasurive afatgjata materiale		(33)	(25)
Te hyrat nga interesi	18	(34,106)	(30,549)
Shpenzimet e interesit	19	5,746	9,660
		(8,032)	(7,230)
Zvogelim/(Rritje) në rezervës së detyrueshme me BQK		531	(6,090)
Rritja e kredive dhe paradhënies për klientët		(29,432)	(50,269)
Rritja në pasuritë tjera financiare		(224)	(361)
(Rritja)/Zvogelimi në pasuritë tjera		(262)	107
(Zvogelimi)/Rritja e detyrimeve ndaj klientëve		(14,195)	58,119
Rritja në detyrime të tjera financiare		924	302
Rritja në detyrime të tjera		106	380
		(50,584)	(5,042)
Interesi i arkëtuar		34,211	29,959
Interesi i paguar		(4,429)	(10,917)
Tatimi në të ardhura të paguar		(926)	(426)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		(21,728)	13,574
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pasurisë së preleshme		(1,134)	(3,025)
Blerjet e pasurisë së papreleshme		(694)	(611)
Blerja e pasurive financiare të disponueshme për shitje		(6,452)	(217)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investuese		(8,280)	(3,853)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare			
Të hyrat nga huatë		(469)	9,898
Kapitali i ri i lëshuar		-	1,000
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financiare		(469)	10,898
(Zvogelimi)/Rritja në para të gatshme dhe ekuivalentët e saj		(30,477)	20,619
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj me 1 Janar, 2013		69,568	48,949
Rritja në para të gatshme dhe ekuivalentët e saj	4.1	39,091	69,568

Shënimet shpjeguese nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014****(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)****1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME**

Në pajtim me rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), TEB Sh.a. (Banka), me 19 Dhjetor, 2007 ka marrë licencën për aktivitete bankare, dhe në Janar 2008 ka filluar operacionet e saj. Zyra Qendrore e regjistruar e bankës gjendet në Prishtinë, Kosovë. Banka operon si bankë komerciale dhe si bankë për kursime, për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në Kosovë, përmes rrjetit të saj prej 25 (2013:26) degëve në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Banka kontrollohet nga TEB Holding, e vendosur në Turqi (kompania amë), e cila ka në pronësi 100% të aksioneve të zakonshme me 31 Dhjetor 2013 (31 Dhjetor 2012: 100% të aksioneve të zakonshme). Aksionarët e TEB Holding janë BNP Paribas dhe Çolakoğlu Group, secili në pronësi nga 50.00% të aksioneve.

Zyra Qendrore e regjistruar e bankës gjendet në rrugën Agim Ramadani, No. 15, 10000, Prishtinë, Kosovë.

Pasqyrat financiare të bankës për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor, 2014 janë aprovuar me 18 Shkurt, 2015 nga Menaxhmenti Ekzekutiv i bankës.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**2.1. Deklarata e përputhshmërisë**

Banka përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të bankës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe trupi paraprak. Krahas kësaj, janë zbatuar interpretimet e publikuara nga Komiteti për Interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (KISNRF) dhe pararendësit e tij.

Pasqyrat financiare SNRF të bankës përbëhen nga pasqyrat e gjendjes financiare, pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimit në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare.

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, përveç ri-vlerësimit të instrumenteve financiare. Politikat parësore kontabël janë të shpalosura si më poshtë.

2.3 Valuta funksionale

Në pajtim me SNK 21, valuta funksionale e Bankës është EUR pasi është valuta e mjedisit primar ekonomik ku banka operon dhe reflekton substancën ekonomike të ngjarjeve.

2.4 Të hyrat dhe shpenzimet e interesit

Të hyrat dhe shpenzimet e interesit regjistrohen në pasqyrën e të hyrave për të gjithat interesat të cilat bartin instrumente në baza akruale duke përdorur metodën e *Yield-it* efektiv.

TEB SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.5 Tarifa dhe komisioni

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifa dhe komisioni të dala nga ofrimi, pra shfrytëzimi i shërbimeve bankare, regjistrohen në pasqyrën e të hyrave ashtu siç janë mbledhur, pra, momentin kur shërbimet janë ofruar, shfrytëzuar.

Tarifat për menaxhimin e kredisë për kreditë, të cilat kanë të ngjarë se do të zvogëlohen, shtyhen (tok me kostot direkte përkatëse) dhe njihen si një përshtatje në normën efektive të interesit të kredisë.

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifa dhe komisioni poashtu përfshijnë tarifën nga letrat e garancionit dhe letrat e kredisë të lëshuara nga banka në të mirë të klientëve, pastaj tarifën që burojnë nga ngarkesat e bankës vendore dhe ndërkombëtare, dhe nga shërbimet tjera që banka ofron.

2.6 Instrumentet financiare

i. Klasifikimi

Pasuritë financiare klasifikohen në kategoritë në vijim: pasuritë financiare të disponueshme për shitje, kredi dhe llogaritë e arkëtueshme. Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga qëllimi për të cilin u blenë instrumentet financiare dhe karakteristikat e tyre.

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme janë instrumente financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në tregjet aktive.

Pasuritë financiare të disponueshme për shitje janë ato të synuara për mbajtje për një periudhë të papërcaktuar kohore, të cilat mund të shitën për nevojën të likuiditetit apo të ndryshimeve në normat e interesit, për nevojë të kursit të këmbimit apo çmimeve të ekuitetit.

ii. Matja

Pasuritë financiare njihen fillimisht me vlerë fer të tyre plus kostot e transaksionit, nëse ka. Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen në vlerën fer plus kostot e transaksionit, nëse ka. Pas njohjes fillestare, ato më pas maten me kosto të amortizuar duke shfrytëzuar metodën e normës efektive të interesit. Kostoja e amortizuar llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Premiumet dhe zbritjet, përfshirë kostot fillestare të transaksionit, janë të përfshira në vlerën kontabël të instrumentit përkatës dhe të amortizuar në bazë të normës efektive të interesit, aty ku është e zbatueshme.

Metoda e interesit efektiv është metodë e kalkulimit të koston së amortizuar të një pasurie financiare dhe të alokimit të të hyrave të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është normë e cila saktësisht zbret rrjedhjet e ardhshme të parasë së vlerësuar (përfshirë të gjitha tarifën në pika të paguara apo pranuar, të cilat formojnë një pjesë përbërëse të normave efektive të interesit, kostot financiare dhe premiumet apo zbritjet tjera) përmes jetëgjatësisë së pritur të pasurisë financiare, apo, ku është e mundshme, një periudhë më e shkurtër.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)**2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)****iii. Instrumentet specifike***Paratë dhe ekuivalentët e parasë*

Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj janë zëra të cilat për një kohë të shkurtër mund të shndërrohen në para të gatshme (më pak se 3 muaj të maturimit origjinal) dhe të cilat i nënshtrohen një rreziku të papërfillshëm të ndryshimit në vlerë. Shumat të cilat kanë të bëjnë me fonde të natyrës restriktive janë të përjashtuara nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj. Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar.

Rezervat e detyrueshme për likuiditet

Në pajtim me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbush kushtin e minimumit të likuiditetit mesatar. Kushti i likuiditetit llogaritet në baza javore si 10% të bazës së depozitave, e definuar si mesatarja totale e detyrimeve depozitare ndaj publikut jo-bankar në EUR dhe valuta tjera, përgjatë ditëve të punës të periudhës mirëmbajtëse. Pasuritë me të cilat banka mund të përmbushë kushtin e likuiditetit janë depozitat e EUR në BQK dhe 50% EUR ekuivalent të parasë së gatshme në valuta të gatshme për konvertim. Depozitat me BQK-në nuk mund të jenë më pak se 5% e bazës depozitare të zbatueshme. Pasi pasuritë përkatëse likuide nuk janë të disponueshme për të mbuluar operacionet ditore të bankës, ato janë përjashtuar nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj për qëllim të pasqyrës së rrjedhës së parasë.

Pasuritë financiare të disponueshme për shitje

Në njohjen fillestare, pasuritë financiare të disponueshme për shitje regjistrohen me vlerë fer plus kostot e transaksionit, nëse ka. Më vonë ato mbahen me vlerë fer. Vlerat fer të raportuara janë ose çmimet e vëzhguara të tregut apo vlera të llogaritura me një teknikë vlerësimi të bazuar në tregun aktual të vëzhgueshëm. Fitimi dhe humbjet që dalin nga ndryshimet në vlerë fer të pasurive financiare të disponueshme për shitje njihen përmes të hyrave tjera gjithëpërfshirëse në pozicionin "rezervat e rivlerësimit nga instrumentet financiare të disponueshme për shitje" deri sa pasuria financiare të çregjistrohet apo paaftësohet. Në këtë kohë, fitimi apo humbja kumulative, paraprakisht e njohur në të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse transferohet në fitim apo humbje përmes ri-klasifikimit. Interesi i kalkuluar përmes metodës së normës efektive të interesit dhe fitimi dhe humbja nga valutat e huaja në pasuritë monetare të njohura si të disponueshme për shitje njihen si fitim apo humbje.

Kreditë dhe paradhënie

Klasifikohen si kredi dhe llogari të arkëtueshme, të cilat maten me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e një pasuri financiare apo obligimi financiar është shuma me të cilën matet apo apo obligimi financiar në njohjen fillestare, minus ri-pagesat e kryegjësë, plus ose minus amortizimi kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv apo çfarëdo dallimi në mes të shumës fillestare dhe shumës së maturimit, dhe minus ndonjë reduktim (përmes shfrytëzimit të ndonjë llogarie të lejuar) për paaftësim apo që nuk mund të mbliidhet. Kreditë dhe avanset raportohen si neto llogaritë e lejuara për zhvlerësimin në kreditë për të pasqyruar shumat e vlerësuara për mbledhje.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014****(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)****2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)****2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)****iv. Çregjistrimi**

Pasuritë financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale në rrjedhë të parasë nga pasuritë financiare skadojnë, apo kur pasuritë financiare transferohen si dhe cilësitë transferuese për çregjistrim. Transaksioni trajtohet si transfer i një pasurie financiare, me ç'rast transferohet i gjithë risku dhe shpërblimi i pronësisë. Kur banka as nuk e transferon dhe as mbanë substancialisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së pasurisë financiare, banka do të përcaktojë nëse ka mbajtur kontrollin mbi pasurinë financiare. Një obligim financiar ç'regjistrohet nga pasqyra e pozitës financiare vetëm atëherë kur të shuhet - kur obligimi i specifikuar në kontratë paguhet, apo anulohet apo skadon, me fjalë tjera, kur obligimi i specifikuar në kontratë paguhet, apo anulohet apo skadon.

v. Zhvlerësimi i pasurive financiare

Një vlerësim bëhet në çdo datë të bilancit të gjendjes nëse ka tregues objektiv se një pasuri financiare apo një grup i pasurive financiare mund të paaftësohet. Nëse dëshmi të tilla ekzistojnë, përcaktohet shuma e vlerësuar e kthyeshme dhe çfarëdo humbje nga zhvlerësimi i asaj pasurie, bazuar në neto vlerën aktuale të rrjedhës së pritur të ardhshme të parasë, dhe evidentohet dallimi në mes të shumës që mund të rikthehet dhe shuma e bartur si në vijim:

Kreditë dhe paradhëniet për konsumatorë raportohen me kosto të amortizuar neto të llogarisë së lejuar për të pasqyruar shumat e vlerësuara të rikthyeshme.

Provizioni i rrezikut të kredisë për humbjen e kredisë krijohet këtu, nëse ka dëshmi objektive se banka nuk do të mund të mbledh shumat sipas kushteve fillestare kontraktuale. Shuma e shpenzimeve është dallimi në mes të vlerës kontabël dhe shumës së vlerësuar të rikthyeshme, e kalkuluar sipas vlerës aktuale të rrjedhave të pritura të parasë përfshirë edhe shuma e rikthyeshme nga garantuesit dhe kolaterali, të zbritura sipas normës fillestare efektive të interesit të instrumentit.

Llogaritë e lejueshme bëhen kundruall vlerës kontabël të kredive dhe avanseve të identifikuara si të humbura në bazë të shqyrtimeve të rregullta të bilanceve të ngelura për të zvogëluar këto kredi dhe avanse në shumat e tyre të rikthyeshme. Llogaritë e lejueshme për kreditë e humbura poashtu mbulojnë humbjet aty ku ka dëshmi objektive se humbjet potenciale janë prezente në komponentët e portofolit kreditor në datën e bilancit të gjendjes. Këto janë vlerësuar në bazë të shablloneve historike të humbjeve në secilin komponent, dhe klasifikimet kreditore të bëra për huamarrësit pasqyrojnë mjedisin aktual ekonomik nën të cilin huamarrësit operojnë.

Banka së pari vlerëson nëse ka dëshmi objektive për paaftësim individual të pasurive, me rëndësi individuale, dhe individualisht apo kolektivisht për pasuritë financiare të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse banka përcakton se nuk ka dëshmi objektive për paaftësim të pasurisë financiare individualisht të vlerësuar, qoftë i rëndësishëm apo jo, përfshin pasurinë në një grup të pasurive financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor, dhe i vlerëson kolektivisht për paaftësim.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)**2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)****v. Zhvlerësimi i pasurive financiare (vazhdim)**

Pasuritë të cilat janë individualisht të vlerësuara për paaftësim dhe për të cilat një humbje e zhvlerësimit është evidentuar apo vazhdon të evidentohet, nuk përfshihen një vlerësimin kolektiv të paaftësisë.

Shuma e humbjes matet si dallimi në mes të vlerës kontabël të pasurisë dhe vlerës aktuale të rrjedhës së vlerësuar të ardhshme të parasë (përfshijë humbjet e ardhshme të kredive të cilat nuk janë bërë), të zbritura në normën fillestare efektive të interesit të pasurisë financiare. Vlera kontabël e pasurisë reduktohet përmes shfrytëzimit të një llogarie të lejuar dhe shuma e humbjes evidentohet në fitim apo humbje. Kalkulimi i vlerës aktuale të rrjedhës së vlerësuar të ardhshme të parasë të një pasurie financiare të kolateralizuar poashtu reflekton rrjedhën e parasë e cilat mund të rezultojë nga kostoja më e vogël e konfiskimit për marrjen dhe shitjen e kolateralit, pavarësisht se a është konfiskimi i mundur apo jo.

Për qëllim të vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut kreditor (me fjalë tjera, në bazë të rrepsit notues të bankës, i cili merr parasysh llojin, industrinë, lokacionin gjeografik, llojin e kolateralit, borxhin aktual dhe faktorët tjerë relevant). Këto karakteristika janë relevante për vlerësimin e rrjedhës së ardhshme të parasë për grupet e pasurive të tilla, që janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat sipas kushteve të kontraktuara të pasurisë që vlerësohet.

Humbja nga zhvlerësimi kreditor dhe i llogarive të arkëtueshme kontabël me kosto të amortizuar përcaktohen individualisht sipas ekspozimit total të klientëve, që tejkalon shumë prej 50 mijë EUR. Pjesa e ngelur e pasurive financiare kontabël me kosto të amortizuar provizionohet sipas rregulloreve të BQK, pas këto rregulla mjaftueshëm justifikojnë nivelin e provizioneve me një perspektivë prudenciale. Procesi për vlerësimin e paaftësimeve merr parasysh ekspozimin kreditor në vonesë më shumë se 60 ditë. Në rast se vlera neto e rikthyeshme për një pasuri financiare është më e ulët se vlera kontabël e pasurisë, atëherë ka nevojë për evidentimin kontabël të zhvlerësimit.

Norma fillestare efektive të interesit përdoret gjatë kalkulimit të shumës së rikthyeshme të një pasurie financiare, e cila përbëhet nga vlera neto aktuale e rrjedhave të ardhshme të vlerësuara të para të nxjerra nga mbledhjet e kredive apo nga likuidimi i kolateralëve. Vetëm hipotekat të cilat TEB-i i ka prioritet për likuidim janë marrë parasysh përgjatë përcaktimit të komponentit të vlerës së kolateralit të shumës së rikthyeshme.

Kategoritë e klasifikimit janë si në vijim:

Kategoria A- Standard

Të gjitha kreditë apo shërbimet tjera të drejtpërdrejta kreditore dhe ekspozimet jashtë bilancore që bartin një rrezik normal bankar. Informacionet në dispozicion në lidhje me ekspozimet kreditore, performansën e llogarisë së klientit, dhe të dhënat financiare që të gjitha këto dëshmojnë se shlyerja e ekspozimit është mjaft e sigurtë dhe nuk ka ndonjë vështirësi (apo obligimi është i siguar plotësisht me kolateral të përshtatshëm). Kredia është aktive, apo delikuenca nuk është vonuar më shumë se tri dhjetë - 30 ditë nga data e kthimit apo maturimit të kredisë. Mbitërheqjet duhet të jenë brenda limitit të caktuar, ose vetëm përkohësisht të tejkalojnë limitin prej 5% ose më pak se 30 ditë, si dhe rrjedha e parasë në llogarinë rrjedhëse është e mjaftueshme për të shlyer bilancin e mbitërheqjes brenda 30 ditëve nga data e skadimit të mbitërheqjes.

TEB SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

v. Zhvleresimi i pasurive financiare (vazhdim)

Kategoria B- Vëmendje e posaçme (ose Vrojtuese) - Ky klasifikim duhet të përdoret për të identifikuar dhe monitoruar ekspozimet që përmbajnë dobësi apo dobësi potenciale të cilat në rastin e rishqyrtimit, nuk e rrezikojnë kthimin e kredisë apo nuk reflektojnë ndonjë potencial për ndonjë humbje, por të cilat, po qe se nuk adresohen apo nuk korrigjohen mund të rezultojnë në keqësimin e kredisë në nën standard apo klasifikim më të ashpër. Në rast se ka mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar që është e pafavorshme, apo këto kredi vonohen më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë atëherë bankat duhet t'i klasifikojnë këto kredi si "Kredi me vëmendje të posaqme", si dhe ato kredi që janë vazhdimisht në mbetje të borxhit në tejkallim të 5% të linjave të aprovuara për më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë. Kjo kategori e klasifikimit është përpiluar që t'ju mundësojë bankave që të identifikojnë dhe adresojnë marrëdhëniet shumë të dobëta që në fazën e hershme.

Kategoria C - Nën-standard - Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, janë definuar qartë dobësitë e kredisë të cilat rrezikojnë pagesën e kredisë në një kurs normal. Një kredi Nën Standard është ajo kredi e cila në bazë të analizave të të dhënave financiare si dhe faktorëve të tjerë, nuk është e mbrojtur për momentin nga vlera e shëndoshë si dhe nga kapaciteti i pagesës së huamarrësit apo garantuesit ose vlera e kolateralit. Kërkohet mbështetje nga ana e garantuesve përgjegjës dhe të aftë për të kthyer kredinë gjë që do të përfshinte edhe negociata të vazhdueshme para se likuidimi i kredisë të kërkojë një klasifikim Nën standard. Nevoja për të kërkuar mbështetjen e kolateralit si mjet për të shlyer obligimin duhet të jetë bazë për një klasifikim Nën Standard.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet Nën Standard, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- Nëse depozitat/rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 60 ditëve që nga data e skadimit të kredisë .
- Nëse klienti e ka tejkalluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 60 ditë pa e paguar këtë tejkallim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- Nëse klienti vonohet për të paguar këstet e kredisë sipas kontratës (duke përfshirë edhe interesin) për më tepër se 60 ditë.
- Nëse afati i kthimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 60 ditë për arsye të mospagimit.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)**2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)****v. Zhvleresimi i pasurive financiare (vazhdim)****Kategoria D-Dyshimtë**

Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, përmbajnë të gjitha dobësitë të cilat janë të qenësishme në kreditë Nën Standarde, por të cilat theksojnë që ekzistojnë mundësitë e forta që pjesa e rëndësishme e shumës së këstit nuk do të paguhet. Ka mundësi të humbjes, mirëpo shumta e saktë nuk mund të definohet saktësisht në rastin e shqyrtimit apo kjo varet edhe nga shfaqja e ndonjë veprimi apo rasti në të ardhmen. Ndonëse mundësia e humbjes është jashtëzakonisht e lartë, për shkak të faktorëve të rëndësishëm dhe të pazgjidhur specifik, por të cilët mund të funksionojnë për të mirën dhe përforcimin e kredisë, klasifikimi i saj si humbje e përafërt mund të shtyhet deri sa të përcaktohet një status më i saktë. Shembuj të faktorëve të tillë përfshihen por nuk janë të limituar në bashkimin, përvetësimin, ristrukturimin e kapitalit, si dhe furnizimin me kolaterale të reja apo plane të reja të rifinancimit.

Garantuesve që nuk bashkëpunojnë apo atyre që janë në një gjendje të dobët financiare nuk duhet të konsiderohen si të aftë për të mbështetur kredinë.

Mbështetje në çfarëdo kolaterali të disponueshëm që nuk do të ishte i mjaftueshëm për të mbuluar shumën gjithashtu mund të arsyetojnë klasifikimin e dyshimtë.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet si i dyshimtë, të paktën nëse kriteret në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat/rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 90 ditëve që nga data e skadimit .
- (b) Nëse klienti e ka tejkalluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 90 ditë pa e paguar këtë tejkallim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkallon 90 ditë.
- (d) Nëse ka mungesë në gjendjen financiare të klientit që ka shkaktuar kapital negativ.
- (e) Nëse afati i kthimit/përfundimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 90 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria E- Kreditë e këqija (humbje) -janë ato ekspozime të cilat të bazuara mbi një analizë të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, kanë vlerë të vogël ose do të kërkojnë një periudhë shtesë për të realizuar ndonjë vlerë dhe nuk janë më të arsyeshme që të mbahen në librat aktive të bankës.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014****(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)****2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)****2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)*****v. Zhvleresimi i pasurive financiare (vazhdim)***

Një ekspozim mund të konsiderohet si i ekspozim i keq (humbje) nëse ndonjë nga kriteret në vijim aplikohet:

- (a) Nëse depozitat/rrjedha e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e mbitërheqjes të papaguar brenda 180 ditëve nga data e skadimit të mbi tërheqjes.
- (b) Nëse klienti e ka tejkalluar limitin e autorizuar të kredisë mbi 5% apo më shumë për mbi 180 ditë pa e paguar këtë mbitërheqje apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkallon 180 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit/data e skadimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 180 ditë për arsye të mospagimit.

Zhvleresimi dhe provizionet për pjesën e ngelur të portofolit të kompanive, pronarëve apo klientëve individual (llogaritë e arkëtueshme nga klientët të cilët individualisht nuk janë relevant) dhe për të arkëtueshmet nga klientët individualisht të rëndësishëm (përveç bankave) për të cilët nuk ka dëshmi të zhvleresimit, kalkulohen në bazë grupore (qasja e portofolit). Huatë në grupe më tutje ndahen në këto kategori, kompani dhe grupe pronarësh të klientëve me pakicë në bilanc të gjendjes. Të gjitha këto tri grupe më tutje ndahen në pesë nën-kategori, A, B, C, D dhe E.

Kur një kredi konsiderohet si e pambledhshme, atëherë shlyhet (write off) ndaj provizioneve përkatëse për zhvleresimin e kredisë. Kreditë e tilla shlyhen pasi të ndërmerren të gjitha procedurat e nevojshme të kompletohen dhe shuma e humbjes të përcaktohet. Rikthimet e mëpashme e shumave që më herët janë shlyer i kreditohet fitimit apo humbjes.

Nëse shuma e provizionit për zhvleresimin e kredisë zvogëlohet më pas për shkak të ndonjë ngjarje pas regjistrimit, atëherë lirimi nga provizioni i kreditohet fitimit dhe humbjes.

Pasuritë financiare të gatshme për shitje - Banka vlerëson në secilën datë të bilancit të gjendjes nëse ka dëshmi objektive se pasuritë financiare të gatshme për shitje janë të dëmtuara. Në rast se investimet e ekuitetit janë të klasifikuara si të gatshme për shitje, atëherë zvogëlimi domethënës apo i zgjatur në vlerën fer të sigurisë nën koston e tij konsiderohet si dëshmi objektive e zhvleresimit. Nëse ekzistojnë dëshmi të tilla, atëherë humbja kumulative hiqet nga të hyrat tjera gjithëpërfshirëse dhe njihet në fitim dhe humbje. Humbjet nga zhvleresimi i njohur në fitim dhe humbjet në instrumentet e ekuitetit nuk janë kthehen përmes fitimit dhe humbjes, dhe rritjet domethënëse në vlerë fer pas zhvleresimit regjistrohen në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse.

Nëse në një periudhë pasuese vlera fer e një instrumenti debitor e klasifikuar si të gatshme për shitje rritet, dhe rritja objektivist mund t'i atribuohet një ndodhie që ka ngjarë pas regjistrimit të humbjes nga zhvleresimi në fitim dhe humbje, humbja nga zhvleresimi kthehet përmes fitimit dhe humbjes.

TEB SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

v. Zhvlerësimi i pasurive financiare (vazhdim)

Për përcaktimin e humbjeve nga zhvlerësimi në instrumentet debitore merren parasysh këta faktorë:

- Dështimi apo delikuenca në pagimin e interesit dhe kryegjësë;
- Vështirësi likuiditeti të emetuesit;
- Shkelja e marrëveshjes apo kushteve të kontratës;
- Bankrotimi i emetuesit;
- Përkeqësimi i gjendjes ekonomike dhe të tregut; dhe
- Përkeqësimi në klasifikimin kreditor të lëshuesit më ulët se niveli i pranueshëm.

Humbjet nga zhvlerësimi i njohur në fitim dhe humbje matet si dallimi në mes të vlerës kontabël të pasurisë financiare dhe vlerës të drejtë aktuale të tij. Vlera fer aktuale e instrumentit është çmimi i tij i tregut apo rrjedhat e ardhshme të diskontuara të parasë, aty ku nuk mund të merret çmimi i tregut.

2.7 Valutat e huaja

Transaksionet në valuta tjera përkthehen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi dhe humbjet nga këmbimi i huaj i cili rezulton nga marrëveshjet e transaksioneve të tilla, dhe nga përkthimi i pasurive dhe detyrimeve monetare në valuta të huaja evidentohen në fitim dhe humbje (si fitim dhe humbje neto e shkëmbimit të huaj).

Zerat jo-monetare të cilat maten në aspektin e koston historike në një valutë huaj nuk ri-konvertohen.

2.8 Pasuritë, prona dhe impiantet

Pasuritë, prona dhe impiantet mbahen me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi, aty ku është e nevojshme. Çdo vit, banka vlerëson nëse ka indikatorë se pasuritë mund të jenë dëmtuara. Nëse ekzistojnë indikatorë të tillë, atëherë vlerësohen shumat e rikthyeshme. Shuma e vlerësuar e rikthyeshme është më e lartë se vlera fer e një pasurie minus koston për ta shitur dhe vlera e saj në përdorim. Kur vlera kontabël e një pasurie është më e madhe se shumta e vlerësuar e saj e rikthyeshme, atëherë shënohet në shumën e rikthyeshme dhe diferenca i ngarkohet fitimit dhe humbjes.

Fitimet dhe humbjet e pronës, objekteve dhe pajisjeve përcaktohen sipas referimit në vlerën e tyre kontabël dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultateve operative për atë periudhë. Riparimet dhe mirëmbajtjet i ngarkohen fitimit dhe humbjet aty ku ka pasur shpenzime.

Zhvlerësimi zbatohet duke përdorur metodën e direkte, përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të dobishme të çdo gjëje të pronës dhe pajisjeve. Zhvlerësimet e mëtutjeshme zbatohen në muajin pasues të blerjes ndërsa për largimin e tyre deri në muajin e largimit nga librat kontabel. Zhvlerësimi nuk fillon derisa pasuritë të jenë të gatshme për shfrytëzim.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)**2.8 Pasuritë, prona dhe impiantet (vazhdim)**

Normat vjetore të zhvlerësimit të përdorura për secilën kategori të pronës, ndërtesave dhe pajisjeve janë:

Kategoria e pasurive**Normat e përdorura të zhvlerësimit**

Përmirësimi i objekteve të marrë me qira	5 vite apo afati i qirasë, cilido që është më i shkurtër
Mobiljet dhe pajisjet tjera	3-5 vite
Kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse	3-5 vite
Automjetet motorike	5 vite

2.9 Pasurite afatgjata materiale

Pasuritë fizike të fituara nga Banka mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet nga dëmtimi, aty ku është e nevojshme. Amortizimi zbatohet në bazë të metodës lineare me normë vjetore prej 20%.

Shpenzimet e mëpasshme në pasuritë e kapitalizuara jo-fizike kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme fizike të mishëruara në pasuritë fizike përkatëse. Të gjitha harxhimet tjera janë shpenzime të shkaktuara. Amortizimi nuk fillon derisa pasuritë të jenë të gatshme për shfrytëzim.

2.10 Pasuritë e konfiskuara

Pasuritë e konfiskuara paraqesin pasuritë financiare dhe jo-financiare të fituara nga banka në zgjidhjen e kredive në vonesë. Pasuritë së pari njihen me vlerë fer atëherë kur merren dhe vendosen në hapësira, dhe pajisje, pasuri tjera financiare apo inventare në kuadër të pasurive tjera varësisht nga natyra e tyre dhe nga qëllimi i bankës përkitazi me rikthimin e këtyre pasurive, dhe më pas rivlerësohen dhe merren pasyrysh në pajtim me politikat kontabël për këto kategori të pasurive.

2.11 Zhvlerësimi i pasurive jo-materiale

Një humbje nga zhvlerësimi njihet sa herë që vlera kontabële e një pasurie tejkalon shumën e tij të rikthyeshme. Shuma e rikthyeshme e një pasurie është më e lartë se vlera fer e saj minus kostoja për shitje dhe vlera në përdorim. Vlera në përdorim e një pasurie është vlera aktuale e rrjedhave të vlerësuara të ardhshme të parasë të pritura nga shfrytëzimi i vazhdueshëm dhe nga hedhja e tij.

2.12 Detyrimet për bankat

Detyrime ndaj bankave janë të regjistruara kur paratë ose asetet tjera janë dhënë avanc në bankë nga bankat palëve tjera. Detyrimet jo-derivative realizohen me kosto të amortizuar.

2.13 Detyrime për klientët

Detyrimet për klientët janë detyrime jo-derivative ndaj individëve, shtetit apo bizneseve dhe mbahen me kosto të amortizuar.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014****(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)****2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)****2.14 Huamarrjet**

Huamarrjet fillimisht regjistrohen me vlerë fer, neto të kostove të transaksionit. Huamarrjet më pas mbahen me kosto të amortizuar. Çdo interes apo tarifë që ka të bëjë me fondet e marura hua është shpenzim sipas normës efektive të interesit dhe e paraqitur në fitim dhe humbje për periudhën.

Kostot e huamarrjes të cilat drejtpërdrejt i atribuohen blerjes, ndërtimit apo prodhimit të një pasurie kualifikuese, regjistrohen si pjesë e kostos të asaj pasurie. Të gjitha kostot tjera të huamarrjes evidentohen si një shpenzim në periudhën në të cilën janë bërë.

2.15 Tatimi në fitim

Tatimi në fitim kalkulohet në bazë të rregulloreve të zbatueshme në Kosovë duke përdorur norma tatimore në datën e bilancit të gjendjes. Efektive nga 1 Janari 2010, norma e tatimit në të hyrat e korporatës është 10% në pajtim me rregulloret e Kosovës për tatim aktualisht në fuqi, Ligji 03/L-162 mbi tatimin në të ardhura të korporatës.

Ngarkimi me tatim në të ardhura në fitim dhe humbje për vitin përbëhet nga tatimi aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual kalkulohet në baza të fitimit të pritur të tatueshëm për vitin, duke përdorur norma tatimore të zbatueshme apo substancialisht në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Fitimi i tatueshëm dallon nga fitimi i raportuar në fitim dhe humbje, ngase përjashton zërat e të ardhurave apo shpenzimeve që janë të tatueshme apo që zbriten në vitet tjera, dhe përjashton zërat që kurrë nuk tatohen apo zbriten. Tatimet tjera, përveç tatimit në të ardhura, regjistrohen në kuadër të shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë në të ardhura llogaritet duke përdorur metodën e obligimit të bilancit të gjendjes për diferencat e përkohshme që dalin nga baza e tatimeve të pasurive dhe detyrimeve, dhe shumat e tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar. Pasuritë e tatimit të shtyrë regjistrohen deri në atë masë që ka të ngjarë se fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i disponueshëm, ndaj së cilave diferencat e përkohshme mund të shfrytëzohen. Pasuritë e tatimit të shtyrë zvogëlohen deri në atë masë sa që nuk ka të ngjarë se përfitimet përcjellëse tatimore do të realizohen.

Detyrimet dhe pasuritë e tatimit të shtyrë maten me normë tatimi që pritet të zbatohet në periudhën kur pasuria realizohet apo obligimi vendoset në bazë të normave tatimore të cilat janë në fuqi apo substancialisht në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Detyrimet dhe pasuritë e tatimit të shtyrë bëhen net kur ekziston e drejta ligjërish e zbatueshme për net pasuritë aktuale tatimore ndaj detyrimeve tatimore, dhe kur ato ndërliiden me tatimet në të ardhura të imponuara nga ndonjë autoritet tatimor.

2.16 Angazhimet e zërave jashtë-bilancor dhe ngjarjet e paparashikuara

Në kuadër të punës së saj, banka ka hyrë në zotime jashtë-bilancore, si garancionet, zotimet për të dhënë kredi, letër kredi dhe transaksione me instrumente financiare. Provizionet për humbje në zotime dhe detyrimet e mundshme mirëmbahet në nivelin adekuat për të absorbuar humbjet e ardhshme të mundshme. Menaxhmenti përcakton provizionet adekuate në bazë të shqyrtimit të zërave individual, përvojës së fundit të humbjes, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të rrezikut të kategorive të ndryshme të transaksioneve dhe faktorëve tjerë përkatës.

TEB SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

2.16 Angazhimet e zërave jashtë-bilancor dhe ngjarjet e paparashikuara (vazhdim)

Kontratat për garancione financiare janë kontrata të cilat kërkojnë nga emetuesi të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për ndonjë humbje të shkaktuar nga një debitor specifik që ka dështuar të paguajë me kohë sipas kushteve të borxhit. Garancionet e tilla financiare i jepen bankave, institucioneve financiare dhe entiteteve tjerë në emër të klientëve për të siguruar kredi, mbitërheqje dhe shërbime tjera bankare.

Garancionet financiare në datën e lëshimit regjistrohen me vlerë fer, e cila është ekuivalente me shumën e tarifës së pranuar. Tarifa amortizohet në fitim dhe humbje përgjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën e linjës së drejtë. Detyrimet e bankës në garancione më pas maten sipas: matjes fillestare, minus amortizimi i kalkuluar për të regjistruar të hyrat nga tarifa përgjatë periudhës së garancionit, apo vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të permbushur obligimin.

Garancioni për kompletim - janë kontrata që kërkojnë nga emetuesi të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një shpenzim të shkaktuar ngase një debitor i caktuar ka dështuar të kryej punën me kohë, në pajtim me kontratën.

Garancionet në datën e lëshimit regjistrohen me vlerë fer e cila është e barabartë me shumën e tarifës së pranuar. Tarifa amortizohet në fitim dhe humbje përgjatë periudhës së kontratës, duke përdorur metodën lineare. Detyrimet e bankës nën garancion më pas maten sipas:

- Matja fillestare, minus amortizimi i kalkuluar për të regjistruar të hyrat nga tarifa përgjatë periudhës së garancionit; apo
- Vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të permbushur obligimin.

2.17 Provizionet

Provizionet njihen kur banka ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, dhe ka shumë mundësi që të ekzistojë një dalje burimesh ekonomike që kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe shuma mund të matet me besueshmëri. Provizionet maten sipas vlerësimit më të mirë të menaxhmentit mbi shpenzimet e kërkuara për të permbushur obligimin në ditën e bilancit të gjendjes dhe zbritet për të prezantuar vlerën aty ku efekti është material.

2.18 Përfitimet e te punesuarve

Banka paguan kontribute për planin pensional të administruar nga Trusti Pensional i Kosovës (TKPK) në baza të obligueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që kontributet të paguhen. Kontributet regjistrohen si shpenzime për përfitim të te punesuarve atëherë kur ato duhet të paguhen.

2.19 Qiratë operative

Pagesat e bëra për qiratë operative i ngarkohen shpenzimeve me menyrë lineare përgjatë kohës së qirasë. Kur një qira operative përfundon para skadimit, çdo pagesë e bërë qiradhënësit përmes penalizimeve regjistrohet si një shpenzim në kohën kur të ndodh shkëputja.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET

Standardet e reja dhe interpretimet e tyre si më poshtë kanë hyrë në fuqi për bankën me 1 Janar 2014:

“Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare” - Ndryshime ndaj SNK 32 (lëshuar në dhjetor 2011 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2014). Ndryshimi shtoi udhëzime për aplikimin e SNK 32 i cili trajtonte mungesën e konsistencës të identifikuar gjatë aplikimit të kriterëve të kompensimit. Kjo përfshin sqarimin e konceptit “ka një të drejtë të detyruar me ligj për kompensim” dhe që disa sisteme të shlyerjes bruto mund të konsiderohen si ekuivalente të shlyerjeve neto. Standardi përcakton se njëse e drejtë për komensim (a) nuk duhet të kushtëzohet nga ngjarje në të ardhmen dhe (b) duhet të jetë i detyrueshëm me ligj në të gjitha rrethanat në vijim: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast likuidimi dhe falimentimi.

“Ndryshimet në Tranzicionin udhëzues në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNRF 27” (publikuar në 31 tetor të vitit 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2014) Amendamenti bëri një përkufizim të një njësie ekonomike të investimeve, si një njësi ekonomike që (i) fiton fonde nga investitorët për qëllim të ofruar atyre shërbimet e menaxhimit të investimeve, (ii) kryen të investitorëve të saj se qëllimi i tij i biznesit është që të investojë fonde vetëm për vlerësimin e kapitalit ose të ardhurat e investimeve dhe (iii) masat dhe vlerëson investimet e saj në bazë të vlerës së drejtë. Një njësi ekonomike investim i kërkohet të japin llogari për degët e saj me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, dhe për të konsoliduar vetëm ato filiale që ofrojnë shërbime që janë të lidhura me subjektet e aktiviteteve investuese. SNRF 12 u amendua për të dhënë informacione shpjeguese të reja, duke përfshirë çdo gjykimeve domethënëse të bëra në përcaktimin nëse një njësi ekonomike është një entitet investim dhe informacion në lidhje me mbështetjen financiare apo tjetër në një filial i pakonsoliduar, nëse për qëllim apo e dhënë për të filialit tashmë. Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

KIFRN 21 - “Taksat” (lëshuar në 20 maj 2013 dhe efektiv për periudhat vjetore nga 1 janar 2014). Interpretimi sqaron kontabilizimin e në detyrimi për të paguar një taksë apo tatim ndryshe nga tatim fitimi. Ky detyrim lind nga një ndryshim në legjislacion që sjell detyrimin për të paguarën apo tatimin. Fakti që një njësi do të vijojë aktivitetin në periudhat në vijim, osë qe përgatit pasqyrat financiare duke u bazuar në parimin e vijmësisë, nuk krijon një detyrim. Ky praim i njohjes aplikohet në pasqyrat financiare të ndërmjetshme apo vjetore. Aplikimi i interpretit për detyrimet që rrjedhin nga skemat e tregtimit të emisioneve është opsionale.

Ndryshimet në SNK 36 - “Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme të aktiveve jo-financiare” (të publikuara në maj 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2014; aplikacioni më herët është i lejuar nëse SNRF 13 zbatohet për të njëjtën kontabilitetit dhe të periudhës krahasuese). Amendamentet heqë kërkesën për të ditur shumën e rikuperueshme kur një CGU përmban emër të mirë ose aktive jo-materiale të pakufizuar kohe jetonin por nuk ka pasur asnjë dëmtim. Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në SNK 39 - “Rinovimi i Derivateve dhe Vazhdimi i Kontabilitetit të Mbrojtjes” (lëshuar në qershor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 janar 2014). Ndryshimet lejojnë që kontabilitetin mbrojtës të vazhdojë në një situatë ku një derivat , i cili ka qenë i caktuar si një instrument mbrojeje, rinovohet (pra, palët kanë rënë dakord për të zëvendësuar kundërpartinë origjinale me një të re) për të kryer anulimin me një kundërparti kryesore si rezultat i ligjeve apo rregullimeve, nëse janë plotësuar disa kushte specifike.

TEB SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (vazhdim)

3.1 Deklarime të reja kontabël

Janë hartuar disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014 ose më vonë, dhe të cilat nuk janë përdorur nga Banka më përpara.

SNRF 9, "Instrumentet financiare: Sqarime dhe Matja" (ndryshuar në korrik 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018). Pikat kryesore të standardit janë:

- Aktivet financiare duhet të klasifikohen në tre kategori matjeje: aktive të matura me kosto të amortizueshme, aktive të matura me vlerën e drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, dhe ato të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjes.
- Klasifikimi i instrumenteve të huasë drejtohet nga modeli i biznesit së njësisë në manaxhimin e aktiveve financiare dhe sipas faktit nëse flukset monetare kontraktuale rrjedhin kryesisht nga pagesat e interesit dhe primit. Nëse një instrument huaje është mbajtur për mbledhje, mund të mbartet me kosto të amortizuar nëse plotëson kushtet e pagesave të primit dhe interesave. Instrumentat e huasë që përmbushin këto kushte mbahen në një portofol ku një njësi mban dhe mbledh flukset monetare nga aktive dhe shet aktive që mund të klasifikohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Aktivet financiare që nuk përmbajnë pagesa për interesa apo prime duhet të maten me vlerën e drejtë në fitim apo humbje (për shembull, derivativë). Derivatet e përfshira nuk janë më të ndara nga aktivet financiare por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të pagesave të primit dhe interesave.
- Investimet në instrumentat kapitale maten gjithmonë me vlerë të drejtë. Drejtimi i bankës mund zgjedhë të paraqesë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që instrumenti mos të mbahet për qëllime tregtimi. Nëse instrumenti i kapitalit mbahet për qëllime tregtimi, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në pasqyrën e fitim humbjes.
- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë mbartur të pandryshuara sipas SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që njësia duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në të ardhurat gjithëpërfshirëse.
- SNRF 9 prezanton një model të ri të njohjes së humbjeve së zhvlerësimit - modelin e humbjeve të pritura të kreditit. Ka një qasje me tre faza e cila bazohet në ndryshimin e cilësisë së kreditit të aktivitetit financiar që nga njohja. Në praktikë, rregullat e reja parashikojnë që njësitë duhet të njohin një humbje direkte të barabarte me humbjet e pritura të kreditit për 12 muaj në njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk preken nga zhvlerësimi i kreditit (apo modeli i përhershëm i humbjeve të pritura të kreditit për llogaritë e arkëtueshme). Kur ka një rritje domethënëse në riskun e kreditit, zhvlerësimi matet me modelin e përhershëm në vend të modelit 12 muajsh. Ky model përfshin lehtësira operationale për qeranë dhe llogaritë e arkëtueshme.
- Kërkesat e kontabilitetit mbrojtës janë rishikuar që të përshtatin më shumë kontabilitetin me manaxhimin e rrezikut. Standardi i jep njësitë mundësi zgjedhje mes aplikimit të kërkesave të kontabilitetit të mbrojtës të SNRF 9 apo me aplikimin e SNK 29 sepse standardi momentalisht nuk adreson kontabilitetin makro të mbrojtjes.
- Banka është duke vlerësuar impaktin e standardit të ri në pasqyrat financiare.

TEB SH.A.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE****Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014****(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç rasteve kur përmendet ndryshe)****3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (vazhdim)****3.1 Deklarime të reja kontabël (vazhdim)**

Ndryshimet në SNK 19 - "Kontributet e punonjësve" (publikuar në nëntor 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 korrik 2014). Ndryshimi lejon njësitë ekonomike të njohin kontributet e punonjësve si ulje të kostos së shërbimit në periudhën në të cilën është dhënë shërbimi i punonjësit, në vend të shpërndarjes të kontributeve për periudhat e shërbimit, nëse shumat e kontributeve të punonjësve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit. Standardi i ndryshuar nuk kishte një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2012 (publikuar në dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014 nëse nuk shprehet ndryshe më poshtë). Përmirësimet përbëhen nga ndryshimet në shtatë standarde.

